



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Shkurt/Mars 2008 • Viti XXV • Nr. 2/3 (161/162) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



PREJ ROBËRISË NË LIRI – PAVARËSI

FAQE 10–11

(Shkruan:
DON LUSH GJERGJI)



BASHKËSIA JONË FESTOI PASHKËT ME GËZIMIN E FALJES DHE PAJTIMIT

FAQE 4

(Shkruan:
DON JETON THAQI)



MESHË FALËNDERIMI NË WILL PËR SHTETIN ZVICERAN

FAQE 5

(Shkruan:
NDUE UKAJ)



■ KËNDVËSHTRIM

Resurrexi. Alleluia

*Mesazhi i Pashkëve i Papa Benediktit XVI
'Urbi et Orbi' – 'Romës e Botës'*

“Resurrexi, et adhuc tecum sum. Alleluia! U ngjalla, e jam gjithnjë me ty. Alleluja!”

Të dashur vëllezër e motra, Jezusi i kryqëzuar u ngjall, përsëritet sot ky lajm i gëzuar: është kumtimi i Pashkëve. E presim me shpirt të mahnitur e mirënjohje.

“Resurrexi, et adhuc tecum sum. Alleluia! U ngjalla, e jam gjithnjë me ty. Alleluja! Këto fjalë të shkëputura nga një variant i lashtë i Psalmi 138 (v. 18b) kumbojnë në fillim të Meshës së sotme. Ndër to, në sa lind dielli i Pashkëve, Kisha njeh vetë zërin e Jezusit që, duke u ngjallur nga vdekja, i drejtohet Atit plot lumturi e dashuri, e brohorët: “Ati im, ja ku jam! U ngjalla, jam përsëri me Ty e do të jem përgjithmonë: shpirti yt nuk më braktisi kurrë”. Mund t’i kuptojmë në një mënyrë të re edhe shprehjet e tjera të Psalmi: “Po u ngjita në qiell, aty të gjej/ndër angrra të dheut po u dorgja, qe se aty të kam!/ Krahët e agimit po mora/ për të zënë vend ku skajin ka deti./ edhe atje më përcjell dora jote./ e djathta jote më shtrëngon për veti./ Po të thoja: “Terrinat së paku kanë për të më mbuluar/ e nata në vend të dritës ka për të më rrethuar/ deri terrinat vetë pranë tejet janë dritë,/ e nata për ty si drita vezullon”. (Ps 138, 8.12).

Është e vërtetë: në natën e pagjumë të Pashkëve, errësira bëhet dritë, nata ia lëshon rrugën ditës që nuk njeh perëndim. Vdekja e ngjallja e Fjalës së Hyjit të mishëruar, është ngjarja e një dashurie të paarritshme, është fitorja e Dashurisë që na çliroi nga skllavëria e mëkatit dhe e vdekjes. Ia ndryshoi faqen historisë, duke i dhënë jetës së njeriut kuptim e vlerë të re.

“U ngjalla, e jam gjithnjë me ty”. Këto fjalë na ftojnë të kundrojmë Krishtin e ngjallur, duke e dëgjuar zërin e tij në zemrën tonë. Me flijimin e tij shëlbues, Jezusi i Nazaretit na bëri bij në shpirt të Zotit, kështu që tani mund hyjmë edhe ne në dialogun misterioz ndërmjet Tij e Atit. Kujtojmë se si një ditë Ai u tha atyre që po e dëgjonin: “Ati më dorëzoi mua gjithçka dhe askush s’mund ta njohë Birin, përveç Atit; e askush s’mund ta njohë Atin, përveç Birit e përveç atij të cilit Biri do t’ia zbulojë” (Mt 11, 27). Duke e parë me këtë sy, vërejmë se pohimi që i bën sot Jezusi i ngjallur Atit: “Jam ende e gjithmonë me Ty” – ka të bëjë edhe me secilin nga ne, “bij të Hyjit e bashkëtrashëgimtarë të Krishtit, në se marrim me të vërtetë pjesë në mundimet e Tij, që edhe të lumnohemi bashkë me Të” (kbs. Rom 8, 17). Në sajë të vdekjes e të ngjalljes së Krishtit, edhe ne sot ringjallemi për një jetë të re e, duke bashkuar zërin me zërin e tij, shpallim se duam të rrimë përgjithmonë me Hyjin, Atin tonë pambarimisht të mirë e të mëshirshëm.

Hyjmë kështu në thellësinë e misterit të Pashkëve. Ngjarja mahnitëse e ngjalljes së Krishtit është thellësisht ngjarje dashurie; dashuri e Atit, që dhuron Birin për shëlbimin e botës; dashuri e Birit, që e lëshon plotësisht veten në duart e Atit për të gjithë ne; dashuri e Shpirtit Shenjt që e ngjall Jezusin nga të vdekurit në trupin e tij të shndërruar. E akoma, dashuri e Atit që e përqafoi rishtas Birin duke e pritur në lumninë e tij; dashuri e Birit i cili, me forcën e Shpirtit Shenjt kthehet te Ati me trupin njerëzor të shndërruar. Nga solemniteti i sotëm, që na bën të jetojmë përvojën absolute e të pashe-mbullt të ngjalljes së Jezusit, buron një thirrje, që na fton të kthehemi në rrugën e Dashurisë; na vjen ftesa, që të mos e pranojmë urrejtjen dhe egoizmin e të ecim në gjurmët e Qengjit të flijuar për shpëtimin tonë, për t’i ngjarë Shpërblyesit “zemërbutë e të përvujtë”, që “u ngjall për shpirtat tonë”.



NDRE DURRËSAKU, Arqipeshkëv i Republikës së Raguzës (II)

FAQE 17

Shkruan:
Prof. Dr. Jahja DRANÇOLLI

Intervista me Kryetarin e Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiun

Paraardhësit tanë, ilirët, kanë qenë promotorët e parë të krishterimit në Evropë

FAQE 12–13



Vëllezër e motra të krishterë nga të katër anët e botës, burra e gra, që *kërkoni me shpirt të singertë të vërtetën!* Uroj që askush të mos ia mbyllë zemrën gjithëpushtetit të kësaj dashurie që ringjall! Jezu Krishti vdiq e u ngjall për të gjithë: Ai është shpresa jonë. Shpresë e vërtetë për çdo njeri. Sot, ashtu siç bëri me dishepujt e tij në Galile, para se të kthehej tek Ati, Jezusi i ngjallur na dërgon edhe ne në të katër anët e botës si dëshmitarë të shpresës së tij, e na siguron: "Unë jam me ju gjithmonë, deri në të sosur të botës" (kbs. Mt 28,20)

Duke ia ngulur sytë e shpirtit plagëve të lumnueshme të trupit të tij të shndërruar, mund të kuptojmë vlerën e vuajtjes, mund të lehtësojmë shumë vuajtje, që vijnë në gjakosin njerëzimin edhe në ditët tona. Në plagët e tij të lumnueshme shikojmë shenjat e pashlyeshme të mëshirës së pafundme të Hyjit, për të cilin flet profeti: Është Ai që shëron zemërplasurit, që mbron të ligshmit, që u shpall lirinë skllëvërve, që ngushëllon të gjithë ata që qajnë, që u jep vajin e gëzimit, në vend të petkut të zisë, këngën e lavdit, në vend të zemrës së trishtuar. (kbs. Is 61,1,2,3). Nëse i afrohem Atij me besim të përvujt, në shikimin e tij do të gjejmë përgjigjen për dëshirat më të thella të zemrës sonë: dëshirën për të njohur Hyjin e për të krijuar me Të një lidhje jetike, që e mbush me dashurinë e tij jetën tonë e lidhjet tona ndërpersonale e shoqërore. Prandaj *njerëzimi ka nevojë për Krishtin*: Në Të, që është shpresa jonë, kemi qenë shëlbuar. (kbs. Rom 8,24).

Sa herë marrëdhëniet ndër-mjet një njeriu me njeriun tjetër, ndërmjet një grupi me grupin tjetër, ndërmjet një populli me popullin tjetër, në vend që të ngrihen mbi bazën e dashurisë, ngrihen mbi egoizmin, mbi padrejtësinë, mbi urrejtjen e dhunën! Janë plagët e njerëzimit, të hapura, plot dhimbje, në çdo skaj të planetit, ndonëse shpesh

injorohen ose fshihen me dashje; plagë që copëtojnë zemrat e trupat e shumë vëllezërve e motrave tona. Ata presin të lehtësohen e të shërohen përmes plagëve të lumnueshme të Zotit të ngjallur (kbs. 1 Pt 2, 24-25) e solidaritetit të atyre që, duke ecur në gjurmët e emrit të Tij, kryejnë gjepte dashurie, impenjohen faktikisht për drejtësinë dhe përhapin rreth vetes shenja të ndritura shprese në vendet e gjakosura nga konfliktet e kudo që dinjiteti i njeriut vijon të poshtërohet e të nëpërkëmbet. Uroj që pikërisht atje të shumëfishohen dëshmitë e butësisë e të faljes!

Të dashur vëllezër e motra, ta lemë veten të na ndriçojë drita e shkëlqyer e kësaj Dite solemne; t'ia hapim me besim të singertë zemrën Krishtit të ngjallur, që forca përtëritëse e Misterit të Pashkëve të shfaqet në secilin prej nesh, në familjet tona, në qytetet tona e në Kombet tona. Të shfaqet në të katër anët e botës. Si të mos mendojmë në këtë çast, posaçërisht për disa vise afrikane, si Darfuri e Somalia, për Lindjen e Mesme të martirizuar e posaçërisht për Tokën Shenjte, për Irakun, Libanin e së fundi, për Tibetin, zona për të cilat inkurajoj të kërkojnë rrugëzgjidhe, që mbrojnë të mirën e paqen! Të kërkojmë plotinë e dhuratave të Pashkëve me ndërmjetësimin e Marisë, e cila, pasi mori pjesë në vuajtjet, mundimet e në kryqëzimin e Birit të saj të pafajshëm, provoi edhe gëzimin e papërshkrueshëm të ngjalljes së Tij. Uroj që Ajo, e bashkuar me luminë e Krishtit, të na mbrojë e të na prijë në rrugën e solidaritetit vëllazëror e të paqes. Këto janë urimet e mia të Pashkëve, të cilat jua drejtoj juve që jeni të pranishëm si dhe burrave e grave të çdo kombi e kontinenti, që na ndjekin përmes radios e televizionit.

Për shumë vjet Pashkët!

BENEDICTUS PP. XVI

Takimi Evropian i Liderëve Fetarë

Më 4 dhe 5 mars në Berlin u mbajt Takimi Evropian i Liderëve Fetarë, me temën "Fetë për Paqe". Kishën Katolike të Kosovës e përfaqësuan Dr. Don Lush Gjergji, famullitar i Prizrenit dhe Dr. Don Shan Zefi, famullitar i Zymit dhe kancelar i Ipeshkvisë. Bashkësinë Islame e përfaqësoi Mr. Qemail Morina, ndërsa Kishën Ortodokse Serbe në diasporë Milan Pejić dhe Dragan Sekulić.


Një seksion i tërë paradoriu iu kushtua kontributit të feve në Kosovë për paqe, dialog, bashkë-

punim dhe bashkëjetesë, duke çmuar lart kontributin tonë para, gjatë dhe pas luftës.

Moderatori dhe kryesuesi i takimit Mons. Gunnar Stalsett, ipeshkëv luteran i Oslos, ndër të tjera tha për Kishën Katolike në Kosovë: "Një Kishë e vogël numerikisht, por me vlerë dhe rëndësi të madhe, Kishë urë dhe ndërmjetësuese për të mirën e të gjithëve...."

Në kumtesën përfundimtare në gjashtë pika u bë edhe koment i shtesë kushtuar gjendjes fetare në shtetit të ri të Kosovës. (D)

Pashkët në Kosovë 2008



Mesha e Vigjiljes së Pashkëve, Prizren

Festa e Ringjalljes është festa më e madhe e Kishës, sepse ringjallja e Jezu Krishtit është e vërteta më e madhe e fesë sonë në Krishtin; e vërteta themelore e besimit tonë, tabani më i sigurt i sigurisë së fesë, e cila që nga Kisha e parë është trashëguar përmes traditës së shenjtë, e themeluar në Shkrimin e Shenjtë të Besëlidhjes së re.

Kjo e kremte e madhe është festuar sivjet më 23 mars nga e gjithë bota katolike. Edhe tek ne në Kosovë është festuar në mënyrë shumë të denjë dhe me plotë përshpirtëri e dëshmi. Zakonisht, festës së Pashkëve i paraprin katërdhjetëditshi i kreshmëve, si përgatitje e përbrendshme e besimtarëve, e mbarë Kishës, për të festuar Ringjalljen e Zotërisë. Javën e fundit të kreshmëve besimtarët katolikë në të gjitha famullitë e Kosovës, rrefehen për të përjetuar Pashkët me zemër të pastruar. Ky hir i sakramentit të rëfimit është i domosdoshëm për të qenë bashkëpjesëmarrës në ringjalljen e Zotit tonë Jezu Krishtit.

Festa e Pashkëve është e pasur me shumë rite liturgjike, duke

ngjallur tek të gjithë ndjenjën e entuziazmit dhe të gëzimit të pamasë, të pranisë së Zotit dhe dashurisë së Tij ndaj neve.

Pashkët e sivjetme në Kosovë kanë pasur edhe një gëzim të shtuar, sepse po i festojmë në shtetin tonë të pavarur. Për shumë arsye janë bërë ngjashmëri emocionuese, se Kosova është ringjallur prej nëntokës, prej robërisë dhe izolimit shekullor dhe tani e përjeton ringjalljen e vet për të qenë e lirë dhe e pavarur. Në të gjitha kishat tonë nëpër Kosovë është ndërjerë kjo frymë e ky gëzim, që bashkë me Krishtin e ringjallur të ngjallemi edhe ne në jetë të re. Edhe ipeshkvi ynë, Imzot Dodë Gjergji në porosinë e Pashkëve drejtuar besimtarëve katolikë dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë ka theksuar dukshëm dhuratën e Pavarësisë sonë dhe ka thirrur në përkushtimin e singertë të të gjithë njerëzve për të ecur përpara, të pajtuar me njëri-tjetrin, e në veçanti thirrja u është drejtuar institucioneve shtetërore dhe politike, përgjegjëse të ndërtimit të një shoqërie të mirëqenë dhe prosperuese.

Zakonisht kumti i Pashkëve

fillon me vigjiljen e të shtunës, kur liturgjia parashihet që ajo të kremtohet në mbremje. Simbolika e begatshme e kësaj nate ka qenë sivjet në mënyrë të veçantë emocionuese në Katedralen e Prizrenit, të cilën e ka udhëhequr ipeshkvi ynë, por edhe në kishën e kryeqendrës sonë në Prishtinë. Në vigjiljen e Pashkëve, sipas traditës së Kishës, pagëzohen katekumenët, të rriturit e që janë përgatitur për pagëzim. Sivjet Kisha jonë është gëzuar shumë duke i pranuar 14 të rritur për pagëzim, 13 në Prishtinë dhe një vajzë në Prizren. Mesha e vigjiljes në katedrale u zhvillua në ora 20:00. Pjesëmarrja e besimtarëve ishte e mirë dhe shumë aktive.

Ditën e Pashkëve mesha solemne u bë në ora 11:00, e udhëhequr nga Imzot Dodë Gjergji, në bashkëmëshim me famullitarin Don Lush Gjergjin, Don Agim Qerkinin, Don Fatmir Koliqin dhe drejtorin e Loyola Gymnazium pater Walter Hapnel SJ. Në mesha kishte të pranishëm edhe personalitete politike nga komuna e Prizrenit dhe rrethinës, si dhe disa përfaqësues të partive politike. Mediat ishin të pranishme, kurse TVPz ka transmetuar meshën drejtpërdrejt.

Imzot Dodë Gjergji gjatë pretkut theksoi gëzimin e kishës për Ringjalljen e Jezu Krishtit, porosinë e të Ringjallurit të dhuruar kishës dhe botës mbarë. Po ashtu ipeshkvi i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në meshë, të gjitha institucionet e Kosovës, partitë politike dhe të gjithë njerëzit tjerë që kanë dërguar telegrame urimi në adresën tonë.

Pas meshe për të gjithë të pranishmit ishte përgatitur një koktej urimi, ku ipeshkvi dhe meshtarët e ordinariatit i pritën mysafirët dhe i këmbyen urimet e Pashkëve. (Drita)



Nga ceremonia e pagëzimit

Porosia e ipeshkvit Dodë Gjergjit për Pashkë 2008

*Drejtuar priftërinjve,
motrave të nderit,
besimtarëve dhe
të gjithë njerëzve vullnetmirë në Kosovë*

"Edbi Jezuesi ... e u tha Paqa me Ju" (Gjn 20,19).

1. Festa e Krishtlindjes ishte krenrtja e gëzimit dhe fillimit të miqësisë sonë me Zotin të "bërë Njeri", i cili duke hyrë në "ngjarjen tonë njerëzore", na ftoj t'i japim lavdi Hyjit dhe të bëhemi paqebartës për njerëzit vullnetmirë mbi tokë. Këtë vit, ende pa e harruar entuziazmin e festës së Krishtlindjes, hymë në kohën e Kreshmëve, për t'u përgatitur për kremtimin e Pashkëve.

2. Koha Kreshmëve ishte koha e lutjes, agjërimit dhe e bamirësisë. Nëpërmjet këtij veprimi të trefshët, kemi arritur të përtërijmë brendinë tonë shpirtërore dhe të forcojmë besimin në Zotin. Kualiteti i përtëritjes sonë të brendshme, përcaktohet me sasinë dhe cilësinë e kushtimit tonë në flim, në kujdesin për të varfër me ndjenjën e dashurisë dhe në pandërpreshmërinë e përpjekjeve tona për paqe mes njerëzve. Fërkimi intensiv i vlerave të përbrendshme shpirtërore dhe përpjekjeve tona të jashtme na aftësojnë të krijojmë një komunikim të thellë, kuptimplotë e të vazhdueshëm me Zotin, nëpërmjet uratës, ndërsa me njëri-tjetrin në duresë, dashuri dhe në falje.

3. Përveç përtëritjes dhe aftësimin tonë për të përjetuar praninë e Zotit ndër ne dhe për të përforcuar shpresën e pjesëmarrjes sonë në përjetësinë e Tij, ne njëkohësisht, këtë të vërtetë, e mbajmë gjallë në kujtesën kolektive të njerëzimit nëpërmes ngjarjes së Kalvarit, kur e lartësuan Zotin tonë në Kryq.

Mundimi dhe vdekja e Krishtit në Kryq, nuk ishte dorëzimi i Zotit para fuqisë njerëzore, të së keqes dhe të robërisë, por vendosmëria e Tij për të mbajtur premtimin e kahershëm, të thënë me gojë të profetëve për faljen e mëkateve tona, për lirinë dhe pavdekësinë tonë. E shpërbliu i mëkateve tona u konkretizua në dëgjuesin e Birit për të shkuar vullnetarisht në vdekje në Kryq, si flim dhe dhurim vullnetar, "Qengji i shtuar, për shpërblimin mëkateve të njerëzimit."

4. Mishërimi i Zotit, Vdekja e Ringjallja e Tij janë dy misteret të përsosura të fesë tonë. Këto dy

fakte, nuk janë mite apo legjenda të krishterëve, por ngjarje reale në historinë tonë njerëzore. Siç është Lindja e Tij e vërtetë, po ashtu është e vërtetë edhe Vdekja e Tij, e cila u kurorëzuar me Ringjallje. Përveç fakteve historike, nuk ka munguar kurrë dëshmia e vazhdueshme e nxënësve, që besuan dhe e ndoqën mësimin e Tij të paqes, shpresës dhe dashurisë. Nuk mungojnë as ata që, tash dy mijë vjet, e mbajnë gjallë shpalljen e këtij "lajmi të mirë", bile, shpeshherë duke e sakrifikuar jetën e tyre personale, që nga ditët e para kur Shën Shtjefnin e mbyten me gurë, e deri të argjipeshkvi i Mosulit Faraj Paulos Rahho, të cilin e vranë në këto Kreshme. Dëshmia deri në martirizim për "lajmin e mirë", nuk ka munguar as në trojet tona në gjitha periudhat historike të popullit tonë, që prej Shën Florit e Shën Laurit të martirizuar në Ulpianën e vjetër, e deri të martirë gjatë diktaturës së fundit komuniste.

5. "U ngjall Krishti, shpresa ime!" Edhe ne sot në këtë festë të Pashkëve, dëshmojmë dhe e shpallim të vërtetën e Lajmit të Gëzueshëm të Ungjillit, se: Krishti, të cilin ne i besojmë, realisht ka jetuar si Njeri, realisht si Njeri ka vdekur dhe realisht me trup është ngjallur. Gjoni i cili mbërriti i para të varri "pa dhe besoi" (Gjn 20,8b). Ringjallja e Krishtit nuk është vetëm një ngjarje e ndodhur dikur, por një veprim i vazhdueshëm i Zotit në jetën tonë njerëzore. Shpresa e Krishtit të Ringjallur nuk nënkupton vetëm "jetën e përtëritjes", por edhe atë të sotmen. Sa e nevojshme është kjo shpresë e gëzimit dhe e paqes për njerëzit e ditëve tona, që janë prangosur në trishtimin e padrejtësive, të varfërisë, të vuajtjes dhe të vdekjes?

Me shpresën e të Ringjallurit dua t'i ngushëlloj të gjitha ato familje që humbën të afërmit e tyre, të plagosurit e të gjithë ata që mbeten pa kullm mbi krye në tragjedinë e Gërdecit të Vorës, në Shqipëri. Sa shumë ka nevojë për ngushëllim familja e policit ukrainas, që e humbën të dashurinë e tyre në Mitrovicë. Edhe shumë e shumë të tjerë që jetojnë në kushte të varfërisë së skajshme, e sa të tjerë që përballen

me vështirësitë e jetës dhe me padrejtësitë njerëzore.

6. Me rastin e Krishtlindjes ju pata thënë se këto janë Krishtlindjet e fundit që po i festojmë në Kosovën tonë të m'varun; tani me gëzim konstatojmë se këto janë Pashkët e para që po i festojmë në shtetin tonë të pavarur dhe të lirë. Duke e falënderuar Zotin për këtë dhuratë, lypet që tani të gjithë të jemi bartës të paqes dhe të dashurisë, që e arritura të meritohet dhe gjithnjë të begatohet.

Jezusi i ringjallur erdhi në mesin e nxënësve dhe u tha: *Paqja me Ju.* (Gjn 20,19). Lus Zotin që kjo klithmë e Jezusit për të pasur paqen, të tingëllojë fuqishëm në zemrën e çdo qytetari të Kosovës. Është e vërtetë që paqja është e siguruar, por ajo s'ka ndodhur ende ndër ne. Paqja, që të gjithë e dëshirojmë, është më se e domosdoshme, prandaj i ftoj kundërshtarët e saj që të frymëzohen nga porosia e Festës së Pashkëve dhe të pranojnë paqen. Edhe ata që paqen e kanë pranuar, nuk duhet të shpenzojmë energji për ta "rahatuar" urrëjtjen që të jetë jovepruese, por lypet ta çrrënjosh atë nga brendia e zemrave tona me falje dhe me pajtim, që të mund të mbizotërojnë dhe ngadhënjëjë dashuria. Ne s'kemi nevojë të ngushëllojmë njëri-tjetrin me aspirata të rrejshme për një të ardhme më të mirë nesër, por duhet t'i përvjellim krahët e t'i përveshmi punës për ta arrit atë sot.

Të gjitha këto ideale, aspirata, nevoja, kërkesa, që janë të thadruara në zemrat tona, gjejnë në Jezu Krishtin e ringjallur mundësinë konkrete të zbatimit, sigurinë e të tashmes së qetë e të lumtur, në vëllazëri, bashkëpunim dhe bashkëjetesë, si dhe premtimin dhe garancinë e pavdekësisë, amshimit të lumtur!

Krishti i kryqëzuar dhe i ringjallur është metodologjia e flimit dhe dhurimit me dashuri, si: Mbajllje me lot e korrije me gëzim.

Për shumë mot Pashkët!

† Dodë GJERGJI,
ipeshkvi i juaj

Ripërtërija shpirtërore e Pashkëve



Letnicë, më 26 mars 2008

Në thirrjen e ipeshkvit të Kosovës, Imzot Dodë Gjergjit, shumë meshtarë dhe motra të nderit morën pjesë në ripërtëritjen shpirtërore në Letnicë, më 26 mars 2008, që u organizua pikërisht në Javën e Pashkëve.

I ftuar ishte ipeshkvi i Bozen - Brixen, Imzot Wilhelm Egger, i cili e mbajti meditimën e tij mbi pjesën e Ungjillit sipas Lukës, kapitulli 24, nxënësit në rrugën për në Emaus, që ishte ungjilli i asaj dite. Ishte kjo një përpjekje për ta zbërthyer tekstin sipas katër kriterëve të Lectio divina, metodë kjo e lashtë dhe efikase për të depërtuar, kuptuar, përjetuar dhe aktualizuar porosinë e fjalës së Hyjit të shkruar në Shkrimin e Shenjtë.

Imzot Egger foli gjithashtu edhe mbi Sinodin e ipeshkvijve që do të mbahet sivjet në Romë, i cili do t'i kushtohet Shkrimi të Shenjtë - Biblës. Meqë ai është edhe anëtar i

komisionit për Sinodin, na shpalosi disa pika kyçe që do të jenë të diskutuara. Pasi që të pranishmit bënë disa pyetje dhe komente, Imzot Dodë Gjergji e falënderoi ipeshkvin e Bolzanos.

Ipeshkvi W. Egger dhe Caritasi i ipeshkvisë së tij, janë donatorët e dy qendrave pastorale në Jagodë dhe në Poterq. Me këtë rast, Imzot Egger u ndau mirënjohje don Aleksandër Kolës dhe Don Vink Palit, dy ish famullitarëve në këto vende, për angazhimin e mirë, për punën pastorale në realizimin e funksionimit dhe menaxhimin të këtyre dy qendrave.

Në mesditë u kremtua Mesha shenjte (latinisht) në kishën e Letnicës, e kryesuar nga Imzot Egger në bashkëmëshim të meshtarëve të pranishëm. Mbas tryezës shpirtërore - Eukaristisë, pasoi edhe tryeza vëllazërore në natyrë, nën qiellin e hapur, e përgatitur nga famullitari i Letnicës, don Kristë Gjergji, me vendasit.

Ishte ky një rast shtegtimi për të gjithë, ku patëm mundësinë të takoheshim e të shkëmbejmë biseda të ndryshme si dhe ta njohim Jezusin e ringjallur i cili na shoqëron në rrugën tonë dhe i cili na shndrit mendjen për t'i kuptuar Shkrimet.

m. Teuta Augustini



Ipeshkvi W. Egger gjatë ligjeratës

Bashkësia jonë festoi Pashkët me gëzimin e faljes dhe pajtimimit



Në odën e pajtimimit

Më 27 shkurt të këtij viti, në pasditen e vonshme në famullinë e Velezhës, arriti një lajm i trishtueshëm dhe tragjik: vrasja e tre bijve të kësaj famullie. Në këtë tragjedi humbi jetën Ndue Kqira, 35-vjeçar, nga fshati Serbicë e Epërme, babë i dy fëmijëve. Në anën tjetër mbetën të vdekur edhe dy vëllezërit Arbër dhe Gjon Kuzhnini nga fshati Smaq, njëri 24-vjeçar dhe tjetri 16, ky i fundit ishte edhe nxënës i shkollës së mesme të mjekësisë në Prizren. Që tre të ishin të punësuar në lokale të argjendarisë e kafeteri të ndryshme, mu në qendrën e qytetit të Prizrenit, në Shadërvan.

Dy ditë më vonë, më 29 shkurt, në ora 13, u bë varrimi i viktimave në varrezat e fshatit Velezhë dhe në ato të Smaqit. Shërbesën e varrimit e kryen meshtarët e kësaj famullie don Franë Kola, famullitar dhe ndihmësi i tij don Jeton Thaqi. Ky ishte një rast tragjik që nuk preki vetëm familjet e viktimave e rrethin e ngushtë, por trazoi zemrat e gjithë famullisë, madje të gjithë ipeshkvisë dhe të mbarë Kosovës. Në këto ditë mbretëronte një atmosferë e zymtë në famullinë e Velezhës, e sidomos në qendrën e qytetit dhe në rrethinë. Dukej sikur një hije apo një re e zezë ta kishte mbuluar tërë trevën e Podrimës. Dhe

ashtu ishte. Hija e zezë i kishte ndalë rrezet e jetës tre bijve tanë, ku në moshën më të mirë tani ata i përpiu dhe i shkretë.

Kjo dhimbje e preku në mënyrë të posaçme bariun e Ipeshkvisë së Kosovës, Imzot Dodë Gjergjin. Nga ky rast dhe rastet e fundit që ndodhën në komunën e Gjakovës, përkatësisht në famullinë e Bistazhinit, ai u detyrua që më 7 mars po të këtij viti ta shkruajë një letër baritore që do të lexohej në të gjitha famullitë e Ipeshkvisë sonë. Në këtë letër ipeshkvi shprehu indinjatën dhe dhimbjen e tij të thellë për rastet e fundit dhe i ftoi të gjithë besimtarët dhe njerëzit vullnet-

mirë që ta luftojnë këtë dukuri shumë negative në shoqërinë tonë kosovare.

Letra baritore e ipeshkvit, grishja e meshtarëve në pajtim dhe falje, lutjet e besimtarëve të shumtë në tokë, e, sigurisht edhe ndërmjetësimi i shpirttrave të lumë në qiell, bënë që këto familje shumë shpejt të bëjnë një hap të domosdoshëm duke i dhënë fund këtij rasti tragjik. Këtu duhet cekur punën e jashtëzakonisht të çmuar të famullitarit Don Franë Kola, i cili qysh nga fillimi deri në mbarim, së bashku me ndihmësin e tij, qëndruan afër këtyre familjeve, ndanë dhimbjen dhe pikëllimin me ta dhe u a predikuan atyre qëndrimin dhe grishjen e Kishës që t'ia shtrijnë njëri-tjetrit dorën e pajtimimit. Kështu që Mark Kuzhnini, axha i dy viktimave, së bashku me Gjergj Kqirën, babai i Nduot të ndjerë, lejuan që Zoti të veprojë në këto dy familje, duke i dhënë fund kësaj ngjarjeje tragjike dhe në një mënyrë duke ia kthyer imazhin e mirë kishës dhe këtij rrethi. Pajtimi u bë së pari në odën e Mark Kuzhninit të Premten e Madhe, me datën 21 mars, në ora 13:00, në praninë e ipeshkvit të Kosovës, Imzot Dodë Gjergjit, famullitarit të Katedrales Don Lush Gjergjit, famullitarit të famullisë së shën Nikollës në Velezhë, Don Franë Kolës dhe ndihmësit të tij, Don Jeton Thaqit. Të pranishëm ishin edhe disa anëtarë të ngushtë të familjes Kuzhnini dhe disa miq e dashamirë. Pas puthjes dhe përqafimit të kryqit të Krishtit, Mark Kuzhnini ia fali këtë dhimbje së pari

ipeshkvit dhe meshtarëve e më pastaj shtriu dorën e pajtimimit me Gjergj Kqirën. Dy orë më vonë, gjatë rriteve të mundimeve të Krishtit, në famullinë e shën Nikollës në Velezhë, që i priu ipeshkvi ynë, i njëjti gjest u konfirmua në praninë e të dy familjeve. Falja ishte e gjithëmbarshme, duke ua mbyllë shtigjet të gjitha atyre thashethemeve të mundshme, por duke mos penguar punën e institucioneve shtetërore e sidomos atyre të drejtësisë. Ndoshta është lehtë të përkshruhet, ndoshta edhe më lehtë të lexohet, por ishte shumë vështirë të përjetohet. Tri lule të pranverës humbën jetën, u shuan në ditët më të mira. U derdhën shumë lot, u çanë shumë zemra, sidomos më vjen të mendoj në zemrat e nënave që përjetuan dhimbjen e bijve të tyre. Por kjo dhimbje shumë shpejt u shndërrua në gëzimin e pajtimimit. Shihja gjatë pajtimimit lot të dhimbjes dhe lot të gëzimit. Ky gëzim i pajtimimit ia mundësoi famullisë sonë dhe mbarë Ipeshkvisë së Kosovës, ta jetojë më intensivisht festën e Pashkëve, e cila, siç thotë edhe shën Ambrozi i Milanos, është kalim prej fajit në falje. Edhe ne si famulli kaluam së bashku me Jezun Krishtin nga e Premtja e Madhe në të Dielën e Pashkëve, në ringjalljen e vërtetë në paqe dhe pajtim. Dhe ky shembull i mirë dhe kjo gatishmëri e faljes, shpresojmë që të jetë model për të gjitha familjet kosovare që sa më shpejt ta përjetojnë pranverën faljes dhe të pajtimimit.

Don Jeton Thaqi



Dy pamje në kishë gjatë pajtimimit të dy familjeve



Meshë falënderimi në Will për shtetin zviceran

Me rastin e Pavarësisë së Kosovës në Will të Zvicrës, në organizim të Misionit Katolik Shqiptar, më 17.02.2008, në ora 13 – u kremtua mesha e Shenjtë, nën drejtimin e Imzot Lucjan Avgustini. Në këtë meshë morën pjesë shumë figura të njohura të kishës dhe politikës, por që e karakterizonte një simbolikë e veçantë dhe shumë domethënëse në vetë, prania e zonjës Michelin Calmy-Rey, ministre e jashtme e Zvicrës, e cila për shqiptarët është bërë një simbol i rëndësishëm i ecjes drejt pavarësisë së Kosovës.



E quajtur Meshë falënderimi ndaj shtetit Zviceran, ajo u karakterizua, përveç me aspektin liturgjik të pasur dhe të përgatitur mirë, edhe me një aktivitet të shtuar, i cili i jepte përmasë të veçantë. Në të vërtetë, ishte e jashtëzakonshme dhe kulmore edhe paraqitja e dhuratave, ku të rinjtë me veshje kombëtare shqiptare dhe zvicerane, paraqitën dhuratat e falënderimit në altar. Në këtë kontekst, vlen për ta dalluar paraqitjen e dhuratave në formë të lules dhe simboleve. Pikësëpari u paraqit *buka, kripa dhe zemra*, simbole këto të lashta të mikpritjes shqiptare. Pastaj të rinjtë sollën një shportë me dhe, në të cilën gjysma e dheut ishte nga Kosova, ndërkaj gjysma tjetër ishte nga Zvicra. Në këtë dhe ishin të ngulitur dhe dy flamuj: njëri ishte flamuri kombëtar i shqiptarëve, ndërsa tjetri ishte flamuri zviceran. Kjo shënjon-te kulmin e një simbolike tejet specifike, që la mbresë të thellë të gjithë të pranishmit në meshë. Më tej, të gjithë besimtarët së bashku u lutën që aty ku ka ndasi, aty të ketë bashkim të njerëzve. Ndërsa në fund të paraqitjes së dhuratave, u ndez një qiri, i cili u vendos në altar, duke i përkujtuar të gjitha viktimat e pafajshme, posaçërisht viktimat e luftës së fundit në Kosovë.

Data 17 shkurt 2008, tanimë ka hyrë në historinë shqiptare, veçanërisht në atë të Kosovës, si një datë e kthesës së madhe, datë e sendërtimit të aspiratave shekullore për liri dhe pavarësi. Kjo datë e prituri me shekuj, me emocione të jashtëzakonshme, u shënjua kudo ku ka shqiptarë, në mënyrë të ndryshme, me emocione e aktivitete të ndryshme. Ndërkaj, një moment me rëndësi në këtë ngjarje, padyshim shënjon aktiviteti i organizuar nga Misioni i Kishës Katolike në Zvicër, respektivisht nga misionari Don Marjan Marku. Në këtë meshë falënderimi mori pjesë Ministria e jashtme e Zvicrës, zonja Michelin Calmy-Rey. Në të vërtetë, kjo ishte një ndër ko incidencat

më interesante të kësaj date me rëndësi, një ko incidencë që do të mbahet mend për shumë arsye. Në këtë meshë merrnin pjesë politikanë, klerikë e qytetarë të shumtë, të cilët ndanë së bashku gëzimet dhe falënderimit përveç tjerash edhe për Pavarësinë e Kosovës. Në meshë të pranishëm ishin meshtarë të shumtë, si Imzot Lucjan Avgustini, ipeshkëvi i Sapës, Josef Rosenast, vikari general në St. Galen; Meinrad Gemperli, famullitar në Will/SG; Don Marjan Marku, misionar në Zvicrën Lindore; Don Lush Sopi, famullitar në Novosellë; Daniel Bachmann, dekan në Fischingen; Dr. Don Mikel Sopi, misionar në Zvicrën Veriperëndimore; Don Anton Uka, kapelan në Klinë; Leo Schenker, famullitar në Tobel.

Përveç kësaj pjesëmarrjeje të madhe të klerit katolik shqiptar dhe atij zviceran, kjo ngjarje u plotësua edhe me njerëz të jetës politike. Nga bota e politikës ishin të pranishëm: Bundesrati Michelin Calmy-Rey, ministere e punëve të jashtme të Zvicrës, zonja Kathrin Hilber, kryetare e qeverisë në kantonin e St. Galen, zonja Muriel Peneveyr, këshilltare diplomatike e zonjës Calmy-Rey, ambasadori Christian Meuwly, shef politik në ministrinë e punëve të jashtme të Zvicrës (EDA), Mehmet Elezi, ambasador i Shqipërisë në Zvicër, Osman Osmani, kantonsrat Bezik Schafhausen, Dr. iur. Bruno Gähwiler, kryetari i komunës në Will, Peter Hungerbühler, kryetar i kishës katolike në Thurgau, Josef Fässler, kryetar i kishës katolike në Will.

Mesha u drejtua nga Imzot Lucjan Avgustini, i cili në predikim foli për mërgimin dhe rëndësinë që ka në Bibël. Ai sintetizoi këtë ditë dhe meshë me ligërimin biblik, duke iu referuar asaj që shkruhet në Bibël dhe që shprehte në esencë pranimin e shqiptarëve të shumtë në Zvicër. Pas predikimit të thukët të Imzot Lucjan Avgustinit, me një fjalim u paraqit Don Marjan

Marku. Ai elaboroi peripecitë që ka përjetuar populli shqiptar për gjatë pesë shekujve në robëri, nën thundra armiqsh të shumtë, prej së cilëve që i detyruar shpeshherë të emigrojnë për të shpëtuar. Në veçanti u theksua eksodi i '99-ës, që ishte një eksod me përmasa biblike. Më tej Don Marjan përmendi rolin dhe qëndrimin tejet pozitiv të shtetit zviceran karshi Kosovës dhe popullit të saj dhe e falënderoi shtetin zviceran për ndihmën e dhënë Kosovës, për pranimin e refugjatëve, për trupat paqësore Swisscoy, për qëndrimin pozitiv ndaj pavarësisë së Kosovës, duke e theksuar po ashtu qëndrimin e Calmy Rey, e cila ishte e para që ka deklaruar në favor të njohjes së Kosovës shtet të pavarur.

Pas fjalës së Don Marjan Markut kori i fëmijëve i Misionit Katolik Shqiptar në Zvicrën Lindore, të udhëhequr nga motrat: Klementina Avgustini dhe Valdete Daka, të veshur në veshje kombëtare shqiptare dhe zvicerane, e kënduan këngën "Danke" – Faleminderit, e të cilën e luajtën edhe me gjeiste.

Pas këngës në radhë ishte fjalimi i zonjës Calmy-Rey, një fjalim që do të hyjë në historinë më të re të Kosovës, sepse bëhet pikërisht në ditën e shpalljes së Pavarësisë së saj. Pas fjalimit të zonjës ministresh, një djale dhe një vajzë, ia dhuruan nga një buqetë lule zonjës Calmy-Rey dhe zonjës Kathrin Hilber. Kjo ishte një dhuratë simbolike: dy buqetë simbolizonin muajin shkurt, ndërsa numri i luleve 17 simbolizonte datën e 17 shkurtit, pra datën kur institucionet e Kosovës shpallën Pavarësinë e Kosovës.

Don Marjan Marku, po ashtu zonjën Calmy-Rey dhe zonjën Kathrin Hilber, në shenjë falënderimi për pjesëmarrjen e tyre në meshën shenjtë, iu dhuroi nga një libër të së lumes Nënë Tereza. Me këtë rast ai tha se: "e lumja Nënë Tereze ishte një ambasadore e dashurisë por dhe një ambasadore e shqiptarëve".

Ndue Ukaj

Fjalimi i Ministres së Punëve të Jashtme të Zvicrës, z. Calmy-Rey

Nëse sot e shikojmë botën, kjo nuk është e përditshme. Dhe fjala e vogël «ne» nuk është e vetëkuptueshme. Sepse ne të gjithë, si zviceranë apo shqiptarë, kosovarë apo serbë, gra apo burra, nga Gjeneva apo St. Galen, ne të gjithë jemi njerëz të ndryshëm, me histori të ndryshme jetësore, me vendlindje dhe gjatë të ndryshme, me pasaporta të ndryshme dhe me prejardhje të ndryshme. Disa jetojnë shumë gjatë në pjesën lindore të Zvicrës, ndërsa të tjerët ndoshta kanë ardhur para një kohë të shkurtër për të gjetur punë, apo historia e botës i ka bërë refugjat në vendlindjen e tyre, sepse ndoshta ata janë një pakicë e vogël religjioze, edhe pse përsëri – apo edhe tani – ashtu është, që njerëzit të mësojnë për të jetuar në një botë prej vlerave të ndryshme dhe përkatësisë fetare.

Zonja dhe zotërinj, çka na bashkon ne sot, në këtë të diele paqësore në Will? Ndoshta, sepse të gjithë jemi në një mënyrë ekspert në marrëdhënie me pakicat dhe shumicat. Shumica e zviceranëve dhe zviceranëve dëshirojnë që pakicat në Zvicër ta ndiejnë veten mirë dhe që të jenë të pranuar, që askush mos t'i shtyjë në skaj për shkak të përkatësisë dhe prejardhjes kulturore apo fetare. Zvicra është një shtet, i cili ka përvoja të lashta në marrëdhënie me pakicat. Dhe ndoshta kjo bën – dhe jo pasaporta e kuqe – një pjesë të vetëkuptimit tonë: që të bisedojmë me njëri-tjetrin dhe askush nuk ka drejtë prej lindjes që të jetë më i mirë apo të ketë të drejtë që t'i shtyjë të tjerët në skaj. Dhe ndoshta, sidoqoftë çdo njeri – i shikuar në vetë – është një pakicë, dhe së bashku me njerëzit e tjerë, në miqësi dhe në një ritëm të përbashkët, në realitet ai (apo ajo) mund të realizojë kuptimin e tij, për një jetë të mbarë dhe në paqe. Nëse kisha, për ta formuluar një rregull të artë për jetën e përbashkët të njerëzve, kishte për të qenë kjo: një shumicë, a është ajo religjioze, politike apo ekonomike duhet të jetë e vetëdijshme për fuqinë e saj. Atë mund ta mbajë për një kohë të gjatë, nëse e mohan lirisht luajtjen e fuqisë së saj.

Zonja dhe zotërinj, shumica prej jush keni përjetuar me dhembe të plotë në jetën tuaj që të jeni pakicë. Juve që jeni këtu të pranishëm, të cilët vini nga Kosova, dëshiroj që t'iu them siç vijon: shumica prej jush keni lënë shtëpitë tuaja, keni ndërpre biografien tuaj për të filluar përsëri, për ta ndërtuar diku tjetër. Dhe ju keni ardhur këtu në Zvicër. Ju keni përjetuar raste tragjike, por ju keni gjetur edhe praninë dhe keni fituar mundësinë për një fillim të ri. Në realitet kjo nuk është asgjë tjetër, veçse ajo çka lexojmë në Bibël. Ne mund të shohim, kudo të dëshirojmë, në Besëlidhjen e Vjetër apo të Renë: Përhërë njerëzit janë në ikje, përhërë është dikush duke e kërkuar tokën e premtuar. Dhe ndoshta, zonja dhe zotërinj, kjo është tokë e premtuar atje ku jeton Hyji i vetëm dhe i vërtetë, por atje ku njerëzit e ndryshëm mund të jetojnë së bashku në paqe. Nëse sot e shikojmë botën, atëherë njerëzve iu dëshirojmë të njëjtin gjë: që përfundimisht të jetojnë me njëri – tjetrin në dinjitet, në liri, pa luftë dhe përcarje; në Afrikë, në lindjen e mesme, në Ballkan, në Kosovë, në Shqipëri, në Berlin, në Parisë, në Qyri, në St. Galen dhe në Will dhe natyrisht dhe në Bernë.

Posaçërisht ata, të cilët ia kanë dalë që të shpëtojnë prej konflikteve tragjike të historisë së sotshme botërore, jashtë të gjitha përjetimeve të dhimbshme kanë një obligim dhe një përgjegjësi: që mos t'i harrojnë ata, të cilët përjetojnë fatin e përndjekjeve, luftërave dhe brutaliteteve. Askush sot nuk mund të jetë i kënaqur, se ai (apo ajo) është i shpëtuar; ne të gjithë kemi mundësinë dhe detyrën për të kontribuar për paqe dhe që mos t'i lëmë të tjerët në fatin e tyre. Cilin Hyj përhërë e lusim, në një të diele, një të shtunë apo në një të premte, nën qiellin e hapur, në një Sinagoge, në një Xhami apo në donjë Kishë: një shërbim i vërtetë Hyjit, i cili krijon një bashkësi, është një kontribut për një botë paqësore.

Ju zonja dhe zotërinj, ndaj njerëzve që kanë mbetur në Kosovë keni një detyrë të posaçme. Ju mund t'iu thonë atyre, sipas përvojës suaj në Zvicër, se jeta e përbashkët është e mundshme në mes religjioneve, gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Ju mund t'iu thonë atyre se mbrojtja e pakicave gjuhësore dhe fetare mund të realizohet vetëm me funksionim të institucioneve të forta. Ne mund të dëshmojmë se pavarësia dhe toleranca, mbrojtja e sigurtë sonë dhe jetesës së përbashkët me bashkësitë e ndryshme, është e mundshme nga marrëveshja (pajtueshmëria). Nëse shembulli i historisë sonë ne mund të tregojmë se pasurimi kulturor, gjuhësor dhe fetar është një burim i fuqisë dhe stabilitetit shtetëror. Për këtë nevojitet dëshira dhe përkrahja e njerëzve, apo së paku dashamirësia e fuqive të mëdha, deri sa të arrihet deri tek një komb i dëshiruar nga një numër i grupeve të huaja. Unë shumë shpresoj se zhvillime të tilla janë të mundshme në Evropë dhe dëshiroj që të ju nis për angazhim përmes lidhshmërive tuaja që keni me të afërmit dhe të njohurit tuaj në Evropën juglindore, që në atë pjesë të kontinentit tonë përsëri të lulëzojë shembulli i suksesshëm i jetës së përbashkët në mes personave, gjuhëve dhe religjioneve të ndryshme.

Ju zonja dhe zotërinj, familjet tuaja, fëmijët tuaj, miqtë tuaj, bartin me vetë nga e kaluara varrë të pashme apo të papashme. Deri sa të shërohen këto varrë duhet kaluar kohë dhe duhet pasur vullnet për të punuar për një ardhmëri sa më të mirë. Ju keni privilegj, por edhe një përgjegjësi për ta shfrytëzuar mundësinë, për ta bërë vendlindjen tuaj shembull për Evropën dhe botën. Ju dhe para së gjithash fëmijët dhe të rinjtë që janë të pranishëm këtu, së bashku me motrat dhe vëllezërit e tyre mund të bëhen ambasadorë të Kosovës, që mos të bëhet një shtet një-kombëtar, por që pasurinë dhe mbrojtjen e pakicave ta mbajnë si një fuqi të vërtetë dhe të madhe.

Ju mund të shpresoni në përkrahjen time të plotë dhe të shtetit tonë. Zonja dhe zotërinj, sot është një ditë jashtëzakonisht e bukur. Të gëzohemi së bashku.

Magdi Allam, gazetar me origjinë egjiptiane, u pagëzua nga Papa Benedikti XVI



Të Shtunën e Madhe, më 23 mars të vitit 2008, në orën 21:00 të mbrëmjes, Ati i Shenjtë, Benedikti XVI, udhëhoqi në Bazilikën e shën Pjetrit në Vatikan meshe soleme në Vigjilje të shenjtë të Pashkëve, e cila, sipas traditës së kishës, fillon me bekimin e zjarrit e me ndezjen e Qiriut të Pashkëve, gjë që Papa e bëri në parahyrjen e Bazilikës së shën Pjetrit në Romë. Vigjilja e Pashëve të Shtunën e Madhe është momenti më i rëndësishëm i gjithë vitit liturgjik, në të cilin kujtohet ngjallja e Jezusit. Në Vigjilje të Pashkës Papa ndan sakramentet e iniciacionit kandidatëve që i paraqet Kisha para tij.

Nga tradita e Kishës tashmë e dimë se Ati i Shenjtë ndan sakramentin e pagëzimit gjatë dy momenteve liturgjike. Njëra është në festën e Pagëzimit të Zotërisë, kur tradicionalisht pagëzohen fëmijët apo ndonjë grup fëmijësh, kurse në Vigjilje të Pashkëve ndan sakramentet e iniciacionit, pagëzimin, krezmimin e kungimin, personave apo grupit të të rriturve, të cilët më parë janë përgatitur në rugën e nevojshme të parapare prej Kishës, rrugë e përgatitjes shpirtërore e katekistike, e cila në gjuhën e

Kishës quhet Katekumenat, kurse personat katekumenë. Këtë vit kishte 7 katekumenë, 5 femra e dy meshkuj. Katekumenët, të cilët këtë vit pranuan sakramentet e iniciacionit të krishterë, vinin nga Italia, Kameruni, Kina, SHBA-të dhe Peruja. Midis tyre ishte edhe Dr. Magdi Allam, një gazetar i njohur me origjinë egjiptiane, zëvendësudhëtar "ad personam" i gazetës ditore të njohur italiane "Corriere della Sera".

Papa gjatë pretkut të shkëlqyeshëm e të thellë teologjikisht, zbrërtheu misterin e Ringjalljes së Jezu Krishtit sipas ungjillit të Gjonit dhe paralajmërimin të tij dhënë apostujve se "do të vijë prapë", do të ringjallet. Pas kësaj lidhi gjërat me sakramentet e Kishës, mes të cilave ai është gjithmonë i pranishëm në mesin e Kishës së vet. Simbolin e ujit, dritës dhe zjarrit në Letrën Hebrëje dhe në Librin e Isaisë dhe rolin e Bariut, i cili na merr për dore e na përcjell në dritën e tij të vërtetë e në jetën e pasosur. "Drita e flaka, të cilat së bashku nuk duan të dëgjin e shkatërrojnë, por ta shndërrojnë njeriun edhe zemrat tona, deri sa të mos bëhemi vërtet njerëz të Hyjit e paqja e tij të bëhet vepruese në botë".

Po ashtu ndër të tjera theksoi se duhet "për t'u kthyer ka Zotëria përherë e përsëri duke u larguar nga drejtimit e gabuara, në të cilat lëvizim shpesh me mendimet tona për të vepruar. Përherë e përsëri duhet drejtohemi kah ai që është Rruga, e Vërteta dhe Jeta". Më tej, Papa në lidhje me kthimin dhe pagëzimin, shtoi: "Përherë duhet të bëhemi të "konvertuarit", duke u kthyer me gjithë jetën ka Zotëria. E përherë e përsëri duhet t'ia lejojmë zemrës sonë që të jetë e përvetësuar nga forca e gravitetit, e cila e tërheq poshtë dhe të ngre përbrenda në lartësi: në të vërtetë, në dashuri" iu drejtua Papa katekumenëve. "Konvertimi nuk është një zgjedhje, e cila përfundon për një ditë, por ai është një qëndrim në tokë që duhet të gjejë plotësi në përditshmëri."

Në mesin e shtatë katekumenëve të pagëzuar, pas përgatitjes shpirtërore e katekistike, më së shumti tërhoqi vëmendjen gazetari i njohur me origjinë egjiptase, Magdi Allam, i cili u konvertua nga Islami në krishterim. Në lidhje me pagëzimin e tij, të shtunën në një deklaratë të lëshuar për shtyp nga Drejtori i Sallës për shtyp të Selisë së Shenjtë, pa-ter Federiko Lombardi, S.J. para

gazetarëve ndër të tjera tha: "Për Kishën Katolike secili person që kërkon Pagëzimin pas një kërkitmi të thellë e përvojë personale, një zgjedhje plotësisht të lirë e një përgatitje adekuatë, ka të drejtë të pranojë pagëzimin".

Kush është Magdi Allam

I lindur në Kairo të Egjiptit në vitin 1952 në një familje muslimane. Si fëmijë ka studiuar në një kolegji katolik salezian në Kairo të Egjiptit. Aty është njohur për së afërmi me kulturën kristiane e fenë katolike. Më vonë emigron në Itali. Ka diplomuar në sociologji në universitetin La sapienza në Romë dhe merret me tematikat e lidhura me Orinentin e afërt e me raportet e tij me Oksidentin. Ka bashkëpunuar me gazetën e përditshme italiane "Il Manifesto" dhe "La Repubblica", pastaj përfundimisht ka hyrë në gazetën e njohur italiane "Corriere della Sera" dhe tash kryen funksionin e zëvendës-redaktorit "ad personam" (e kjo nënkupton: pa ngarkesë përgjegjësie në linjën politike të gazetës). Ai është jash-tëzakonisht i pasionuar në temat që tregojnë realitetin në bashkëjetesën sociale në Oksident, si identiteti nacional dhe demokracia, imigracioni e integrimi, islami e terrorizmi. Ka publikuar

shumë shkrime të veta, si "Rroftë Izraeli. Prej ideologjisë së vdekjes në kulturën e jetës: historia ime" (2007) "E dua Italinë. Por a e duan italianët?" (2006), "Për ta mundur frikën. Jeta ime kundër terrorizmit islamik e pandërgjegjësisë e "Oksidentit" (2005), "Kamikazët made in Europa, a do t'ia dalë Oksidenti t'i shkulë terroristët islamikë?" (2004), "Sadam. Historia sekrete e një diktatori" (2003), "Bin Ladeni në Itali. Një rrugë në islamin radikal" (2002), "Ditari i Islamit" (2002). Ka punuar si komentator politik në transmetimet televizive në Mediaset (Kanale5, Italia, Retequattro) e që janë televizionet më të shikuara në Itali. Ka marrë shumë çmime nacionale e internacionale, ndër të cilat çmimin "Saint-Vincent di Giornalismo" (Shën Vinku i gazetarisë), medaljen e senatit të Republikës së Italisë, të dorëzuar nga Qendra Piu Mancu, "L'Ambrogino d'Oro" nga komuna e Milanos, çmimin internacional "Dan David" dhe "Mass Media Award dell'American Jewish Committee".

Gazetar me famë nacionale, është një ndër pjesëmarrësit më me ndikim në debatet mes raporteve të Oksidentit e botës arabe, si argumente që flasin për këtë, janë shkrimet e shumta të tij, në bazë të së cilave është mbështetur shumë herë në debatet televizive politike.

Njerëzit që e duan, te ai shohin shpesh modelin e një myslimani të moderuar e një arab plotësisht të integruar në botën, në kulturën e në sistemin e vlerave të Oksidentit. Kurse nga përgjohësit mbahet si një personazh i pabesueshëm, i cili lëshon urrejtje dhe dyshim, duke bartur lajme të padokumentuara, të pavërtetë ose gjëra plotësisht false.

Ai për vete thotë: "Në krishterim kam gjetur qartësinë e së vërtetës dhe se Dita e Pashkëve është dita më e lumtur e jetës së tij sepse ka sjellë në zemrën e tij dritën e fesë së vërtetë". Kurse për Kishën Katolike, ata që hyjnë në katekumenat dhe pagëzohen, thotë: "të gjithë janë të barabartë e Kisha i shikon pa bërë dallime personale, që do me thanë se të gjithëve janë njësoj të rëndësishëm para dashurisë së Hyjit e janë të mirëerdhur në bashkësinë e Kishës".

Magdi Allam ka marrë në pagëzim emrin Kristian.

Don Nikson SHABANI

Përlavdimi dhe përçmimi i martesës dhe familjes

Çdo mashkull dhe çdo femër ëndërron për një martesë dhe familje të lumtur. Të dhënat e fundit tregojnë se në mbarë Evropën familjes i jepet një domethënie e madhe, që i tejkalon edhe fushat e tjera qendrore të jetës, siç është puna apo koha e lirë. Ajo konsiderohet si më e rëndësishmja nga grupet e moshave 40 deri 55 vjeç. Vlerë më të ulët i japin personat shumë të rinj dhe ata në moshë të shtyrë. Siç tregojnë të dhënat e vitit 1999 në përjashtime me ato të vitit 1990, nuk është konstatuar ndonjë ndryshim i madh në vlerësimin e familjes.

■ SHKRUAN:

P. Shtjefën DODES SJ

Më ndryshimet themelore në strukturat sociale, ekonomike dhe politike të Evropës, mund të pritët edhe një ndryshim në qëndrimet ndaj martesës dhe familjes. Para se gjithash martesë, më shumë në shtet të perëndimit, gjithnjë e më shumë po vihet në pyetje, varësisht nga vlerësimi i bërë prej të pyeturve nga Evropa lindore apo perëndimore. Dhe është e arsyeshme të pyetet: a ka kuptim fare martesë dhe a ishte dashur të nxitet të rinjtë në martesë.

Ekspertë të ndryshëm nga lëmi i jetës martesore, sjellin të dhëna interesante të atyre që janë për dhe kundër martesës. Të parët vejnë në dukje qëllimin e dashurisë bashkëshortore shpesh të pasqyrtuar, por gjithmonë të pranishëm: të plakshë bashku dhe të qëndrosh së bashku edhe pas vdekjes. Çdo dashuri bashkëshortore përmban në vete edhe përjetësinë. Bashkë me kënaqësinë, dashurinë bashkëshortore gjithmonë e shoqëron edhe ndjenja e zgjatjes, amshimit të saj. Çdo dashuri bashkëshortore përmban në vete edhe përjetësinë.

Ata që mbajnë qëndrim negativ ndaj martesës, si argument sjellin dhe tregojnë për përvoja të hidhura nga jeta martesore e të tjerëve dhe janë të tmerruar nga martesë tradicionale. Disa të tjerë e shprehin madje nevojën e tyre që të jenë "të lirë" dhe të mos lidhen ngushtë për dikë. Shumë njohës me eksperiencë në fushën e martesës konsiderojnë se një qëllim i tillë, pa përgjegjësi, nuk mund ta ndërtojë një lidhje të thellë, të lumtur dhe të pasur të dashurisë. Këta persona nuk hyjnë me tërë qenien e vet në një lidhje martesore, dhe kështu vetë i qesin kufij vetvetes.

Është e vërtetë se çiftet – nëse dëshirojnë të jenë të lumtur së bashku – duhet gjithmonë sërishtmi të zbulojnë, të ripërthijnë dhe ta freskojnë lidhjen e tyre. As dëshmia e martesës (dokumentet), as ceremonitë e ndryshme të jashtme, por as mosdëshira për t'u martuar, nuk i japin çiftve garanci të lumturisë, garanci kundër rutinës, monotonisë dhe zhgënjimit.

Disa çifte besojnë në idealin e martesës dhe familjes, mirëpo kanë frikë se në kohën tonë nuk do të mund t'i dalin këtij ideli. A nuk është e vërtetë, se shumë të njohur të tyre të dashuruar lumturisht, janë martuar, por pas

disa viteve janë ndarë? A është dashuria e përhershme? A mund të jetohej 40-45 vjet i lumtur me një njeri? Ekspertët u japin të drejtë dhe thonë se pyetje të tilla janë krejt të arsyeshme. Këtu vejnë në dukje se sot njerëzit për të parën herë pas shumë shekujsh, në të shumtën e rasteve vejnë kurorë nga dashuria, dhe jo për shembull që të përkujdeseshin njëri për tjetrin, që së bashku të udhëhiqnin një ndërmarrje familjare, që të mund të kishin shumë fëmijë. Këtu është edhe një gjë e re që çiftet sot vetë dhe me vullnet të lirë vendosin a janë njëri për tjetrin, pra për këtë nuk vendosin baballarët, nënat, priftërinjtë, xhaxhallarët apo "ndërmjetësues" të tjerët "amatorë martesorë".

Personat lidhin kurorë për arsye se duhen dhe presin që njëri-tjetrin në dashurinë e tyre do ta bëjnë të lumtur. Liria dhe dashuria janë mundësi dhe shpresë për njerëzit e ditëve tona dhe njëkohësisht sfidë që s'mundet çdonjëri t'i bëjë ballë. Liria dhe dashuria nuk janë automatizëm i lumturisë, ato kërkojnë një sjellje të shqyrtuar dhe të angazhuar; dashuria gjithsesi kërkon durim, orvatje, sakrificë, pajtim. Dy që dashurohen nuk i kënaqin gjithmonë pritshmërisë e partnerit të tij/saj, nganjëherë i krijojnë dhimbje dhe zhgënjim njëri-tjetrit.

Personat lidhin kurorë për arsye se duhen dhe presin që njëri-tjetrin në dashurinë e tyre do ta bëjnë të lumtur. Liria dhe dashuria janë mundësi dhe shpresë për njerëzit e ditëve tona dhe njëkohësisht sfidë që s'mundet çdonjëri t'i bëjë ballë. Liria dhe dashuria nuk janë automatizëm i lumturisë, ato kërkojnë një sjellje të shqyrtuar dhe të angazhuar; dashuria gjithsesi kërkon durim, orvatje, sakrificë, pajtim. Dy që dashurohen nuk i kënaqin gjithmonë pritshmërisë e partnerit të tij/saj, nganjëherë i krijojnë dhimbje dhe zhgënjim njëri-tjetrit.

Jeta është e shumëfishtë kështu që edhe dashuria po ashtu. Në dashurinë bashkëshortore ekziston rreziku i recidivit të traumave jetësore, por edhe shansi i shërimit, thonë psikoterapistët. Ajo i përsërit dhe rigjallëron përjetimet traumatike, traumatizon, por edhe shëron. Të duash dhe të jesh i dashur në martesë siguron shëndetin dhe zgjat jetën. Përjetimi i marrëdhënies bashkë-

shortore ka ndikim dramatik në shëndet. Sëmundjet zvogëlohen për gjysmë për ata që jetojnë në raportin cilësor bashkëshortor.

Dashurisë bashkëshortore i takon për të qenë njëri pranë tjetrit edhe në kohëra të vështira. Ajo kërkon besim, mbështetje, dëshirë

kuptim; nëse janë të gatshëm në sakrificë dhe flim dhe nëse mund t'i durojnë zhgënjimet; nëse ata të dy e vlerësojnë mirë njëri-tjetrin, i respektojnë anët e mira të tyre, mirëpo nuk i mbyllin sytë para veseve dhe nuk ngarkohen për së tepërmi me dëshirën që njëri për tjetrin të jenë gjithçka në botë; nëse e marrin vesh se përcaktimet dhe ligjet mund të jenë edhe ndihmë, se mund të shërbejnë edhe si udhëzime, e lirojnë individin në vendimet e tij dhe e mbrojnë nga qejfi vetanake; nëse çiftet kanë miq të përbashkët me të cilët mund t'i ndajnë gëzimet dhe frikësimet, brenat dhe detyrat; dhe, më një fund, nëse çiftet së bashku vendosin për vlerat që vazhdimisht i japin kuptim dhe përmbajtje jetës së tyre.

Si duket, shumë prej këtyre që u cekën këtu, flasin në favor të një njohjeje serioze, shtojnë njohësit e problematikës familjare. Sepse, para se çifti t'i thotë njëri-tjetrit Po-në përfundimtare, do të duhej të njiheshin më mirë. Kuptohet, nevojitet "përgatitja martesore" serioze: të shqyrtosh në mënyrë kritike vendimin mbi jetën e përbashkët; të krijosh plane të përbashkëta jetësore; të njihen më mirë njëri me tjetrin (Kush është partneri im? Çfarë ndien ai? Çfarë do të dëshironte? Çfarë shpresash ka? Çfarë pret? Çfarë domethënie kam unë për të? Çfarë historie ka lënë pas vete? Cilat janë "rënjët" e tij?); të mësosh dhe t'i ushtrosh disa veti (t'i shprehësh ndjenjat tua, gjithmonë ta dëgjosh tjetrin dhe të provosh ta marrësh vesh, hapur t'i pastrosh konfliktet, të jesh i durueshëm dhe të mundesh të pritsh, të falësh, të kënaqesh dhe të gëzohesh, të ndihmësh, të jesh në harmoni).

Dashuria bashkëshortore, pra, është një fenomen kompleks dhe i ndërlikuar njerëzor. Përbëhet nga rastësia, frika, kërkimi i marrjes në mbrojtje, nevoja për siguri, agresiviteti, lidhja, seksualiteti, të mbijetuarit, por përbëhet edhe prej mekanizmeve të pavetëdijshme dhe tentimeve të vetërealizimit. Shumë partnerë martesorë humbin në malin e këtyre kundërshtive të mëdukshme të dashurisë martesore. Në vend që në këtë pasuri mundësisht dhe shansesh ta realizojnë lumturinë personale dhe të përbashkët, ata dëshirojnë të ikën nga gjithë kjo, gjë që veprojnë në mënyrë shumë të ngathtë dhe, në vete të dëmshme. Pasojat janë divorcet (ndarjet) në mënyrë katastrofale të këqija dhe johumane, që shpesh shndërrohen në një luftë të pakuptimtë, në dëm për të dy partnerët bashkëshortorë.

Për fat të keq, ëndrra për një martesë të lumtur në shumicën e rasteve mbetet vetëm ëndërr. Është e sigurt se nuk mund të kërkojmë të na bëhet parajsë këtu në tokë, por duket se shumë zhgënjime të panevojshme do të mund të mënjanoheheshin, në qoftë se do të mendonim më shumë mbi dukjet e tilla, të të cilat vihet gati në të gjitha familjet dhe të mësohemi të komunikojmë: të dimë të dëgjojmë tjetrin dhe ta shprehim atë që mendojmë dhe ndiejmë dhe për to të bisedojmë. Ky është hapi i parë për një zgjidhje dhe vendim me baza të shëndosha për një jetë të tillë.

Nuk ka martesë pa konflikte të cifteve bashkëshortore dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme afërsia e tyre për të pasur qasje ndaj komunikimit bashkëshortor. Është me rëndësi edhe si çift të drejtoshen barazi ndaj vetes dhe ndaj partnerit në komunikimin bashkëshortor dhe ta pranosh lojën e pavetëdijshme të përbashkët në të.

Nga prizmi i teologjisë së krishterë mund të shtojmë edhe këtë: se format e jetës të partneritetit, martesës dhe familjes, e formojnë praktikën e fesë në një mënyrë specifike, të pazëvendësueshme. Përsëritëria martesore dhe familjare njihen si mishërim i fesë së krishterë në "format" e martesës dhe familjes. Ndërmjet besimit të krishterë dhe jetës bashkëshortore, gëgjësisht familjare, ekziston një korrelacion i dyanshëm: marrëdhëniet bashkëshortore dhe familjare e formojnë marrëdhënien me Jezu Krishtin dhe marrëdhënien me Jezu Krishtin i jep formë martesës dhe familjes.



“ Personat lidhin kurorë për arsye se duhen dhe presin që njëri-tjetrin në dashurinë e tyre do ta bëjnë të lumtur. Liria dhe dashuria janë mundësi dhe shpresë për njerëzit e ditëve tona dhe njëkohësisht sfidë që s'mundet çdonjëri t'i bëjë ballë. Liria dhe dashuria nuk janë automatizëm i lumturisë, ato kërkojnë një sjellje të shqyrtuar dhe të angazhuar; dashuria gjithsesi kërkon durim, orvatje, sakrificë, pajtim. Dy që dashurohen nuk i kënaqin gjithmonë pritshmërisë e partnerit të tij/saj, nganjëherë i krijojnë dhimbje dhe zhgënjim njëri-tjetrit. ”

për familjarizim, përsëritje të pasionit. Ajo është kompromis i gjallë dhe e lidhur me situatën në të cilën të dyja anët fitojnë. Dashuria bashkëshortore pa konflikte është iluzion. Kompromisi cilësor ndërmjet burrit dhe gruas kërkon dialog të afërsisë e çiftit bashkëshortor së bashku t'i zgjidhin konfliktet.

Martesa nuk ishte dashur të ishte diçka vetvetiu e kuptueshme. Ajo është vendim i vetëdijshëm që mund të silltë vetëm me vullnetin e lirë pas një shqyrtimi themelor. Sot, thonë ekspertët, martesë ka kuptim: vetëm nëse të dytë janë të gatshëm për një lidhje partnerësie/bashkëshortësie; nëse janë të gatshëm në dialog; nëse janë të gatshëm t'i mbajnë brenat së bashku dhe t'i zgjidhin detyrat e jetës martesore dhe familjare; nëse të dytë e dinë se dashuria e tyre mund të zhvillohet; vetëm nëse të dytë kanë mjaft duresë dhe mirë-

E në qoftë se Krisht

Misteri i Ngjalljes së Krishtit është ngjarje reale, e cila pati manifestime historikisht të konstatuara, sikurse pohon Besëlidhja e Re. Rreth vitit 56 Shën Pali u shkruan të krishterëve të Korintit: "Më së pari ju shpalla ato të vërteta që edhe unë vetë i mora: se Krishti vdiq për mëkatet tonë sikurse e paralajmëroi Shkrimi Shenjt. Që varrosur e të tretën ditë u ngjall së vdekuri si u tha në Shkrimin Shenjt. Iu duk Kefës e pastaj të Dymbëdhjetëve. Pastaj iu duk vëllezërvë që ishin së bashku më shumë se pesëqind vetë, prej të cilëve shumica janë ende gjallë e disa kanë vdekur. Pastaj iu dëftua Jakobit e mandej të gjithë apostujve. Më së fundi mu dëftua edhe mua – dështakut

■ SHKRUAN:
Luz PANUKO

Që në nismë, në gjirin e Kishës, lindën rryma, mendimet të ndryshëm apo tentativa të manipulimit të mësimi të krishterë, me ndikimet që vinin nga filozofia greko-romake, pra nga këndvështrimi filozofik (gnositikët) dhe nga qasjet semite – hebraike, pra nga këndvështrimi teologjik (implicimi heterodox i teologjisë judeo – kristiane). Rrymat e këtyra vazhduan të ekzistojnë edhe më tutje me paraqitjen e rrymave të tjera të quajtura heretike – esotike. Fjala është për literaturën e ashtuquajtur apokrifë. Kisha, në anën tjetër, has edhe në vështirësi të tjera, në ato të jashtme, të cilat shpërthejnë në përndjekje dhe bëhen kundërshtarë të repte me shkrime (siç ishte Celsi e shumë të tjerë). Ndaj këtyre dukurive, Kisha duhej të merrte një qëndrim. Kështu edhe u arrit një qartësi në shumëllojshmërinë e shkrimeve dhe mësimëve. Zgjedhja e Kodit, gjatë Sinodeve dhe Konicilëve kishtare, e përcaktoi Simbolin e Fesë, që e rrëfijmë gjatë Flisë së Shenjtë apo Meshës.

Tentime që të shpjegohen disa gjëra të misterit, apo vënia në dyshim e Thesarit të Fesë, sikurse ka ndodhur gjatë shekujve të kaluar, ndodh edhe në ditët e sotme. Mjerisht, kjo ndodh edhe në mes besimtarëve katolikë shqiptarë. Të tilla provokime janë, bë fjalë, paraqitja e Dëshmitarëve të Jehovit e disa sekte të tjera, në njërin anë, dhe, në anën tjetër, tentimi i rrënimin të thelb të krishterimit, sikurse është romani i D. Brown-it. Mund të themi, se që nga fillimi është vënë në pyetje, në një anë, Njerëzorja (natyra njerëzore) e Krishtit Zot dhe, në anën tjetër, Hyjnorja (natyra hyjnore) e Jezusit Zot dhe njeri. Të themi, se pos kësaj, në dy shekujt e fundit është vënë në dyshim edhe vetë ekzistimi historik i Jezusit.

Duhet pranuar se tentimet

dhe teoritë e këtyra, edhe pse nuk janë të pranuar, shpesh bëjnë të lindin dyshime dhe lëkundje të disa besimtarë të pasigurt në bindjen e tyre fetare, që vinë nga mosnjohja e Shkrimit Shenjt apo nga injoranca e tyre ndaj doktrinës së krishterë. Mirëpo, edhe dyshimi mund të jetë konstruktiv, në qoftë se zgjon dëshirën për rreke serioze të njohjes së drejtë të doktrinës së krishterë.

Premtimi dhe realizimi i planit të Hyjit nuk mund të veshet vetëm në Ngjallje. Plani shpëtimprurës i Hyjit fillon me Mishërimin e Birit të Tij, me paraqitjen dhe veprimin publik, njerëzia e ngjashmëria me njeriun, "përpjesëtimin", deri në përjetimin e vdekjes, "deri në vdekje në Kryq" (Fil 2, 8), të Ngjallurit, kthimi tek Ati, dërgimi i Shpirtit dhe vetë Kisha e Tij. Plani i Hyjit është i formuar në disa periudha, por është një e vërtetë.

Varri dhe eshtrat e Jezusit

Vitin e kaluar (viti 2007), disa ditë para festës së Ngjalljes së Jezusit, prodhuesi kinematografik, James Cameron dhe gazetari Simcha Jacobovici kanë prezantuar përmbajtjen e filmit dokumentar dhe librit të tyre "Varri i humbur i Jezusit". Në afërsi të Jerusalemit, në Talpiot, gjatë hulumtimeve arkeologjike, në vitin 1980 është gjetur një varr me disa eshtra. Sipas Cameroni dhe Jacobovicit, të ndihmuar nga disa arkeologë, në këtë varr familjar ishin, pos tjerash, edhe eshtrat e Jezusit. Jacoboci dhe Cameroni janë të bindur se varri i Jezusit nuk gjendet nën Bazilikën e Varrit të Shenjt. Varri i Jezusit, që prej shekullit të parë, është adhruar në vendin ku gjendet sot Bazilika. Shtegtimi i të krishterëve në këtë vend, bëhet edhe në kohën e impe-

ratorit Adrian. Ky, në vendin e ashtuquajtur Varri i Shenjtë, në vitin 139, e ndërton një tempull hyjit Giovit. Qëllimi i tij ishte ta profanojë Kalvarin. Mbretëresha Helena në vitin 315 këtë tempull pagan e zhveshi dhe doli në dritë monumenti modest i ndërtuar prej të krishterëve. Sot në vendin e Kalvar ekziston një Bazilikë, e cila quhet Bazilika e Varrit të Shenjtë. Mbi varrin e Jezusit në Kalvar arkeologët më seriozë në botë nuk kanë kurrfarë dyshimi. Prandaj edhe duhet të ceket se ky është një element shumë i rëndësishëm. Prezantimi i gjetjes së kinse eshtrave të Jezusit

“Të gjithë besojnë që Jezusi ka vdekur. Kjo edhe nuk është vështirë të besohet. Të besosh në Ngjallje të Krishtit, prandaj edhe në ngjallje të njeriut si fryt i Ngjalljes së Tij, nuk është e lehtë, sepse esencialja mbi besimin e këtyrë është e papashme për sytë e njeriut. Është e nevojshme të hapen sytë për të shikuar në brendinë e ngjarjeve, e për këtë është i nevojshëm hiri Zotit. Kjo është edhe njëra prej arsyeve pse të gjithë nuk besojnë se Krishti është ringjallë. Në Ngjallje besojnë vetëm të krishterët. Ai që nuk beson në Ngjallje nuk mund të quhet i krishterë.”

në këtë varr familjar, do të ishte provë se trupi i Jezusit nuk është ringjallë, sikurse pohojnë Ungjijtë, prandaj në këtë mënyrë vihet në dyshim dhe mohohet Ngjallja e Jezusit. E në qoftë se Jezusi nuk është ngjallë, atëherë ky nuk është Zot(!) dhe kështu krishterimi merr një kuptim krejt tjetër, pasi që themeli dhe burimi i këtij besimi bazohet në Ringjalljen e Jezusit. Në qoftë se Krishti nuk është ngjallë, nuk ka shfaqjesim, humb zanafilla dhe e shtron burimin e ngjalljes së ardhshme.

Rikonstruktimi historik

Apostujt, nxënësit dhe përcjellësit, të cilët kaluan një kohë me Jezusin dhe besonin se ky ishte Mesia, janë dëshmitarë të

arrestimit, të gjykitimit, të kryqëzimit dhe të varrimit të Jezusit. Përjetimi i ditëve të fundit, bëri që këta të mendojnë se gjithçka mori fund. Shumica prej tyre mendojnë të kthehen në nëpër shtëpitë e tyre. Pas një kohe, disa prej tyre rrëfejnë se Jezusin e kanë parë të gjallë. Kapitujt e fundit të katër Ungjijve janë përplot me dëshmi të takimeve mes Jezusit të ngjallur dhe disave prej këtyre dishepujve. Dëftimi i Mësuesit dhe pastaj edhe zbritja e Shpirtit Shenjt, i premtuar nga vetë Jezusi, transformohen në dëshmitarë të ngjarjeve. Duke e dëshmuar këtë ngjarje, këta themelojnë bashkësi, duke filluar nga Jerusalemi e gjer në Romë, sipas Veprave të Apostujve. Do theksuar se shumë dëshmitarë të Jezusit të ngjallur, apostujt dhe shumë nxënësit, e japin jetën e tyre duke predikuar të vërtetat e përjetuara lidhur me ngjalljen e Krishtit. Shpjegimi i gatishmërisë në flijimin e jetës së tyre është bindja në bazë të përvojës së tyre me paraqitjet e Jezusit të ngjallur.

Ata e takuan, patën përvojë, përjetuan Krishtin, e panë për së afërmi, i panë duart dhe këmbët e therura me gozdhë dhe varrën në krahatorin e Tij, prandaj dëshmuar të vërtetën e pamohueshme të Ngjalljes së Jezusit.

Ringjallja si ngjarje historike dhe e tejkohshme

Në çfarë mënyrë mund të flitet mbi historicitetin e ndodhës, faktit, ngjarjes? Varet se çka kuptohet me historicitet. Në qoftë se mendohet në diçka vetëm materiale, e kjo ndodhi në kohë dhe hapësirë, ngjallja nuk mund të prezantohet si ngjarje historike. Nuk ekzistojnë prova bindëse shkencore dhe nuk ka dyshim se nuk e kemi të krijuar mundësinë të zhvilloj-

më hetime duke përdorur metoda shkencore. Me këtë nuk dëshirohet të thuhet se Ringjallja nuk ka ndodhur, por që nuk mund të pretendohet që kjo të demonstronhet në mënyrë shkencore.

Por, në qoftë se me historicitet mendohet kalimi përtej kohës dhe hapësirës, me shenja, me indikacione të drejtimit brenda kohës dhe hapësirës, atëherë mund të bisedohet mbi historicitetin e Ngjalljes, i cili jep shenja dhe porosi historike e që janë: varri i zbrazët, pëlhurat e palosura, takimet e nxënëseve, apostujve dhe të tjerëve me të ngjallurin.

Katekizmi i Kishës Katolike është tejet i qartë në këtë gjë: "Misteri i Ngjalljes së Krishtit është ngjarje reale, e cila pati manifestime historikisht të konstatuara, sikurse pohon Besëlidhja e Re. Rreth vitit 56 Shën Pali u shkruan të krishterëve të Korintit: "Më së pari ju shpalla ato të vërteta që edhe unë vetë i mora: se Krishti vdiq për mëkatet tonë sikurse e paralajmëroi Shkrimi Shenjt. Që varrosur e të tretën ditë u ngjall së vdekuri si u tha në Shkrimin Shenjt. Iu duk Kefës e pastaj të Dymbëdhjetëve. Pastaj iu duk vëllezërvë që ishin së bashku më shumë se pesëqind vetë, prej të cilëve shumica janë ende gjallë e disa kanë vdekur. Pastaj iu dëftua Jakobit e mandej të gjithë apostujve. Më së fundi mu dëftua edhe mua – dështakut".

"Njëmend, askush nuk ishte dëshmitar okular i ndodhës së Ngjalljes. Asnjëri ungjilltar këtë nuk e përshkruan. Askush prej tyre nuk mund të tregonte apo të përshkruante se si ndodhi kjo fizikisht. Ngjarje historike, e konstatuar përmes shenjave të varrit të zbrazët dhe realiteti i takimeve të Apostujve me Krishtin e ngjallur. Ringjallja si fenomen e kalon historinë dhe mbetet Misteri i fesë. Për këtë arsye, Krishti i ngjallur nuk manifestohet para botës, por paraqitet para nxënëseve të vet "atyre që ishin nisur me të nga Galilea në Jerusalemin", të cilët "tani janë dëshmitarë e tij para popullit" (Vap 13,31).

i nuk është ngjallur?

Jezusi i ngjallur përcaktoi raporte të drejtpërdrejta me nxënësit e vet, përmes kontaktit dhe përbashkimit në ngrënie. 'Shikoni duart e mia e këmbët e mia: Unë jam vetë! Më prekni dhe vërtetojuni! Shpirti nuk ka mish as eshtra. Si po shihni, Unë i kam! Si u tha kështu, u dëftoi duart e këmbët' (Lk 24,39). Pra, nxënësit e Jezusit panë se ishte trupi i Krishtit, i cili kishte pësuar mundime dhe ishte kryqëzuar.

Besimi në Zotin e ngjallur kërkon fe, besim e besimi bazohet në një fakt. Fakti i besimit është Jezusi nga Nazareti, Zot e njeri, se për ndryshe krejt kjo do të ishte një iluzion.

E thamë më lart se feja gjithnjë e ka një fakt si bazë për gjetjen e përmbajtjes së vet. Me fjalë të tjera: feja është një shikim, dhuratë e Hyjit, për ta pranuar të vërtetën e vetë faktit, në rastin e të vërtetës mbi Ngjalljen e Jezusit në shenjat e dëshmuara.

Gjendja e natyrës njerëzore e Krishtit të ngjallur

Ç'ndodhi me trupin e Jezusit të ngjallur? Sipas teorisë së kinematografit të përmendur, trupi i Jezusit e ka pasur fatin e të gjithë trupave të tjerë. Provë janë eshtrat e gjetura në Talpiot. Po çfarë ishte trupi i Krishtit të ngjallur, atëherë kur u takua me apostujt, me nxënësit e vet dhe me shumë të tjerë, sikurse na dëshmojnë Ungjijtë dhe Shën Pali?

Ja ç'thotë Katekizmi i Kishës Katolike mbi këtë të vërtetë. 'Jezusi i ngjallur përcaktoi raporte të drejtpërdrejta me nxënësit e vet, përmes kontaktit dhe përbashkimit në ngrënie'.


Jezusi iu thotë nxënësit të vet: "Shikoni duart e mia e këmbët e mia: Unë jam vetë! Më prekni dhe vërtetojuni! Shpirti nuk ka mish as eshtra. Si po shihni, Unë i kam! Si u tha kështu, u dëftoi duart e këmbët" (Lk 24,39). Pra, nxënësit e Jezusit panë se ishte trupi i Krishtit, i cili kishte pësuar mundime dhe ishte kryqëzuar.

Në Katekizëm vazhdojmë të lexojmë: "Ky trup autentik dhe real në të njëjtën kohë ka veçori të reja të një trupi të lavdishëm; ky trup më nuk është i vendosur në hapësirë dhe në kohë, mirëpo mund të bëhet i pranishëm (prezent) në mënyrë të vet kur dhe ku të dëshirojë, sepse njerëzia e tij s'mund të mbahet mbi tokë, por tashmë ai i përket hapësirës hyjnore të Atit. Edhe për këtë arsye Jezusi i ngjallur është përsosmërisht i lirë të dëftohet sikurse do ai vetë".

E në qoftë se për njëmend Jezusi nuk është ngjallur?

Teologu Sandro Vitalini, në këtë pyetje përgjigjet: "Nuk do të ndërronte në mënyrë absolute asgjë. Fitorja e Krishtit nuk është e lidhur me një vend a për një gur, por është fitore e Birit të Hyjit mbi vdekjen, i cili i tërheq të gjithë njerëzit. Në fund të fundit Jezusi ende të Premten e Shenjtë i thotë cubit të kryqëzuar afër tij: "Sot do të jesh me mua në parajsë". Të Premten e Shenjtë ne e shohim tashmë Ngjalljen, fitoren mbi vdekje dhe të ngjiturit e tij në qiell, glorifikimin e natyrës njerëzore të Krishtit si dhe në festën e Rrëshajëve mbizotërimin ndaj ligjeve fizike. Pashkët tona nuk bazohen mbi një gur, por mbi fenë në Ngjalljen dhe fitoren ndaj vdekjes. Për këtë arsye, kur e vunë në varr, pasi që është i bashkuar Fjalës në mënyrë hipostatike – në lavdi, andaj nuk ekziston mundësia që eshtrat e Krishtit do të gjenden, sepse janë të trasfiguruar në lartësinë e lavdishme të vetës së tij".

Të gjithë besojnë që Jezusi ka vdekur. Kjo edhe nuk është vështirë të besohet. Të besosh në Ngjallje të Krishtit, prandaj edhe në ngjallje të njeriut si fryt i Ngjalljes së Tij, nuk është e lehtë, sepse esencialja mbi besimin e këtitë është e papashme për sytë e njeriut. Është e nevojshme të hapen sytë për të shikuar në brendinë e ngjarjeve, e për këtë është e nevojshëm hiri Zotit. Kjo është edhe njëra prej arsyeve pse të gjithë nuk besojnë se Krishti është ringjallë. Në Ngjallje besojnë vetëm të krishterët. Ai që nuk beson në Ngjallje nuk mund të quhet i krishterë. Shën Pali thotë: "Në qoftë se me gojë e dëshmon se Jezusi është Zot dhe në qoftë se në zemrën tënde e beson se Hyji është ngjallur prej të vdekurish, do të shëlbosh. Pra, për të fituar drejtësinë duhet të besosh me zemër e për të fituar shëlbimin duhet të dëshmosh fenë me gojë". (Rom 10, 9-10) Kjo dëshmi me gojë dhe besim në zemër është e mundur "veçse nën veprimin e Shpirtit Shenjt" (1 Kor 12, 3).





Duke e falënderuar së pari Zotin, drejt aktuale, bashkësinë ndërkombëtare dhe kërkesa, domosdoshmëria u realizua me Kosovës, si fryt flijimi, pune dhe angazhimi "lindi" shteti më i ri në botë, tashmë i ri botërore.

Prej robërisë në

■ SHKRUAN:

Don Lush GJERGJI

Çështja e Kosovës, apo siç e quanin disa analistë edhe "rasti i Kosovës", gjatë viteve 1981-1989, 1989-1999 dhe së fundi 1999-2008 vërtet në shumëkrah ishte i dalluar, specifik dhe unik në ish-Jugosllavinë dhe më gjerë.

Demonstratat paqësore studentore në fillim të vitit 1981 ishin një "klithmë" e fuqishme ndaj Jugosllavisë së atëhershme, Evropës dhe botës, se bashkëjetesa e dhunshme e popujve të saj pas vdekjes së Titos tashmë ishte vështirësuar, pothuaj kishte përfunduar. Ishin dy mundësi apo përcaktime themelore: ndarja apo shkatërrimi i shtetit jugosllav, që ishte krijesë "artificiale" e fuqive të mëdha pas rrënimit të dy perandorive, të Austro-Hungarisë dhe të asaj turko-otomane, apo reformimi, modernizimi dhe demokratizimi, konfederalizimi si proces i domosdoshëm për të mbijetuar.

Demonstratat në fillim ishin kryesisht paqësore dhe studentore, pastaj u zgjeruan në klasën punëtore, dhe së fundi u shndërruan në një lëvizje gjithëpopullore. Përgjigjja e Serbisë - Jugosllavisë ishte tejet e ashpër, mjaft e egër, me kufizime, kërcënime dhe cungime të llojllojshme të lirisë, burgime, plagosje, vrasje dhe dhunë.

Centralizmi beogradas - serb arriti ta bindte dhe "detyronte" opinionin jugosllav se lëvizja jonë ishte shoviniste, separatiste, fundamentaliste islamike, deri edhe kanibaliste.

Opinionet evropian dhe botërore asohere as që merrej me këtë çështje, sepse kishte halle tjera tejet të ndjeshme, si "So-

lidarnoshq" në krye me Lech Walensen në Poloni, murin e Belinit dhe shumëkrah tjetër, si "konfronti" apo "lufta e ftohtë" mes dy blloqeve ushtarake, NATO-s dhe Paktit të Varshavës. Prandaj botës i nevojitej di-kush në Jugosllavi që me dorë të fortë dhe të sigurt do ta mbante atë nën "kontroll".

Gjatë viteve 1981-1989 Serbia ishte organizuar për një lloj "revanshizmi" ndaj Titos dhe Kushtetutës së Jugosllavisë të vitit 1974, e cila ishte risi dhe mjaft demokratike për kohën dhe botën e atëhershme socialiste. Forcat e errëta nacionaliste serbe organizohen dhe bashkohen në kërkimin dhe gjetjen e mënyrave për krijimin e Jugosllavisë së tretë, de facto të "Serbisë së Madhe".

Kështu Lëvizja e Kosovës që keqinterpretuar dhe shtypur me dhunë nga të gjitha viset jugosllave, për të arritur deri te ndërrimi i Kushtetutës së Jugosllavisë dhe heqja dhe pezullimi i autonomisë sonë, që edhe ashtu ishte e brishtë dhe tejet e vogël.

Jugosllavia e atëhershme, por edhe bota, nuk e kundërshtuan aq këtë vendim, sepse shumica e konsideronin këtë si çështje të brendshme serbo-shqiptare, e si të tillë jo edhe aq të rrezikshme, të rëndësishme dhe vendimtare për Jugosllavi dhe më gjerë.

Mirëpo Serbia nuk kënaqej më me kaq, por në stilin e "fintimarit" krenar ndërmori veprimet e ndryshme për ta mposhtur edhe qeverinë e Malit të Zi dhe të Vojvodinës, duke sulmuar udhëheqësinë e tyre si antiserbe, antijugosllave dhe nacionaliste të rrezikshme. Kështu gjysma e Jugosllavisë tashmë ishte "Serbi" me katër njësi, dhe kjo ishte e

mjaftueshme për t'i sulmuar dhe nënshtruar edhe katër njësitë tjera, mendonin ata, Slloveninë, Kroacinë, Bosnje dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë.

Kjo ishte zanafilla e luftës 10-vjeçare vëllavrasëse mes popujve të ndryshëm të ish-Jugosllavisë, e shkaktuar kryesisht nga hegjemonizmi dhe nacionalizmi serb.

Po të ishin kuptuar mirë dhe drejt klithma, kushtrimi, porosia jonë e vitit 1981, nuk do arrihej pezullimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989, më vonë edhe i Malit të Zi dhe të Vojvodinës.

Gjatë gjithë këtyre viteve të vuajtjeve dhe sprovave të llojllojshme për popullin shqiptar në Kosovë, fuqia informative,

mbrojtëse dhe mobilizuese ishte Kisha Katolike në krye me Imzot Nikë Prelën (1918-1996), i cili me tërë qenien e tij shpirtërore dhe morale e paraqiti gjithkund trimërisht, guximshëm, gjenden tonë reale dhe luftoi kundër shpifjeve, njollosjeve, gënjeshtreve, paragjytimeve dhe sulmeve të ndryshme.

Qëndrimi i tij, si dhe i pasardhësve të tij, Imzot Mark Sopi (1938-2006) dhe ipeshkvit tanishëm Imzot Dodë Gjergji, i Kishës Katolike vendore dhe të përgjithshme, ishte parimi tashmë i njohur i arqipeshkvit tonë Imzot Pjetër Bogdanit i cili thoshte: "Fati im është fati i popullit tim!"

Një kontribut të jashtëzakonshëm e kanë dhënë për Kosovën edhe dy personalitetet e larta botërore, Papa Gjon Pali II (1929-2005) dhe e Lumja Nëna Tereze (1910-1997), që do të mbesin të shënuar në mendjet dhe zemrat tona, në historinë tonë.

Gjatë vitit 1990 populli shqiptar në Kosovë e dha "pjesën më të mirë të vetvetes", si do të thoshte e Lumja Nëna Tereze, duke u bashkërenditur në tri lëvizje gjithëpopullore: a) Pajtimin e gjaqeve apo luftën kundër gjak-dhe-hak-marrrjes; b) bamirësia nëpërmjet SHHB "Nëna Tereze"; c) krijimin e sistemit paralel shëndetësor dhe shkollor.

Këto tri lëvizje të "Pranverës



*tësinë dhe vuajtjet tona shekullore dhe
vëllazërinë, bashkëpunimin tonë, nevoja,
ë 17 shkurt 2008 me shpalljen e Pavarësisë së
zhimi vendor-ndërkombëtar. Kështu së fundi
njohur në më se 30 shtete të rëndësishme*



ë liri – pavarësi



tonë të Madhe 1990" e afruan, bashkuan dhe vëllazëruan popullin shqiptar në Kosovë, por edhe më gjerë, dhe na dhanë "brumin" për ngjarjet e ardhshme, për lëvizjet demokratike, partitë politike, sidomos LDK-në në krye me dr. Ibrahim Rugovën (1944-2006).

Me këtë u krijua mundësia e manifestimit të strategjisë paqësore dhe jodhunore, i informimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, gjë kjo që ishte parakusht vendimtar për ndërhyrjen e botës për shpëtimin tonë.

Serbia tashmë me vite ishte e zhytur në luftë kundër Sllovenisë, Kroacisë, sidomos kundër

Bosnje dhe Hercegovinës, dhe kudo hasi në rezistencë të vendosur të këtyre pjesëve, por edhe të mbarë botës demokratike.

Pas humbjeve të njëpasnjëshme aparatit policor-ushtarak s'kishte më mjete për t'u mbrojtur dhe për të mbijetuar përpas nëpërmjet Kosovës, apo hapjes së të ashtuquajturit "frontit të jugut", duke e shtuar dhunën gjithnjë. Qëllimet e tyre ishin të qarta dhe djallëzore, shkaktimi i trazirave shqiptare si shkas dhe rast, mundësi për masakrim në përmasa popullore, si dhe përhapjen e luftës në Ballkan dhe më gjerë. Mirëpo paria jonë e atëhershme dhe populli këtë e kuptuan fare mirë dhe nuk ranë

në gracka dhe provokime, sepse ishte krijuar kështu qëndrimi dhe përballimi heroik:

të përballojmë çdo gjë dhe t'i durojmë të gjitha për të evituar masakrimin apo edhe përgjysmimin e popullit! Po ashtu edhe bashkësia ndërkombëtare më nuk ishte naive apo indiferente ndaj këtyre dukurive tejet negative.

Por çdo gjë ka kufi, edhe durimi. Gjatë viteve 1997-1999 doli në skenë UÇK-ja, si mbrojtje e domosdoshme e popullit dhe qëndresë e armatosur kundër diktaturës serbe, dhunës, pastimeve etnike...

Kështu qëndresës paqësore dhe jodhunore iu "bashkëngjit"

edhe lufta apo rezistenca e armatosur e bijve dhe bijave tona, duke krijuar kështu binaren për mbrojtjen, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Bashkësia ndërkombëtare, veçmas SHBA-ja, deri diku edhe BE, e kishin të qartë se çka ndodhte në Kosovë, sepse OSB-ja ishte vëzhguese dhe monitoruese e gjendjes ndër ne. Pasi dështuan të gjitha kërkimet dhe bisedimet paqësore për zgjidhjen e kësaj gjendjeje të padurueshme në Kosovë, bota në krye me SHBA-në, Bill Clintonin, NATO vendosi të ndërhynte ushtarakisht për ta larguar diktaturën serbe dhe për ta shpëtuar popullatën shqiptare.

Pas 78 ditëve dhe netëve të bombardimeve të NATO-s në Kosovë dhe në Serbi, u nënshkrua në Kumanovë kapitullimi dhe largimi përfundimtar i ushtrisë dhe policisë serbe nga Kosova.

Ankthi, frika, dhembja, dhuna, gjakderdhja fatbardhësisht morën fund. Eksodi shqiptar e "ndërroi" drejtimin, nuk kishte më largim nga Kosova, por kthim në Kosovën e larë me gjak, edhe një herë martire. "Pranvera jonë e Madhe" e vitit 1990 po kurorëzohej në vitin 1999.

Ndërhyrja ndërkombëtare ishte e dyfishtë, ushtarake, nëpërmjet NATO-s, duke krijuar forcën ushtarake multietnike mbrojtëse në Kosovë, KFOR-in; dhe civile, nëpërmjet OKB-së, me administrimin ndërkombëtar me anë të UNMIK-ut.

Këto dy prani ndërkombëtare kanë mundësuar zgjedhjet e lira dhe krijimin e pushtetit vendor në nivelin komunal dhe qendror, si dhe formimin e strukturave bazë shtetërore: Kryetarin, Par-

lamentin, Qeverinë, formimin e SHPK-së dhe TMK-së si forca mbrojtëse vendore.

Presidenti i ndërë i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, duke e zburur "ngarkesën" mes krahut paqësor dhe atij luftarak kosovar, urtisht e krijoi koalicionin mes LDK-së dhe AAK-së, duke krijuar kështu një atmosferë pozitive dhe konstruktive për proceset dhe zhvillimet tona demokratike.

Më vonë Grupi i Unitetit me katër partitë më të mëdha të Kosovës, LDK, PDK, AAK, ORA dhe ekspertët, ka punuar bashkërisht pozitë dhe opozitë në kërkimin e zgjidhjes përfundimtare – pavarësia e shtetit të Kosovës.

Më prapë pala serbe pati qëndrime hegjemoniste dhe të "papërshtatshme", si ndaj bashkësisë ndërkombëtare, aq më tepër ndaj strukturave tona komsovare.

Mirëpo, duke falënderuar së pari Zotin, drejtësinë dhe vuajtjet tona shekullore dhe aktuale, bashkësinë ndërkombëtare dhe vëllazërinë, bashkëpunimin tonë, nevoja, kërkesa, domosdoshmëria u realizua më 17 shkurt 2008 me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, si fryt flijimi, pune dhe angazhimi vendor-ndërkombëtar.

Kështu së fundi "lindi" shteti më i ri në botë, tashmë i njohur në më se 30 shtete të rëndësishme botërore.

Tani Kosova e "posalindur" ka nevojë për rritje dhe përparim sa më të mirë, që të jetë shtet model i lirisë dhe demokracisë, bashkëjetesës dhe pluralizmit, për integrimin ndërkombëtar, parakusht ky i domosdoshëm për integrimin tona euro-atlantike.



Intervista me Presidentin e Republikës së Kosovës Fatmir Sejdiu

Paraardhësit tanë, ilirët, kanë qenë promotorët e parë të krishterimit në Evropë



Zotëri president, Kosovën e kanë pranuar shumë shtete, por kanë mbetur ende shumë pa e pranuar. Me çfarë ritmi pritet të ecin shtetet e tjera që të na pranojnë? Kur pritet të na njohë Selia e Shenjtë?

F. Sejdiu: Unë mund të them se ne kemi marrë një vendim jashtëzakonisht të rëndësishëm, që është vendimi i shekujve për pavarësimin e Kosovës në parlament, dhe, mund të them, se ka qenë vendim i koordinuar me të gjithë mbështetësit e Kosovës në të gjitha periudhat që kemi kapërcyer, të bashkëpunimit me ta. Flas, në radhë të parë, për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për vendet e rëndësishme të Bashkimit evropian, por edhe të vendeve të tjera të botës demokratike. Prandaj nuk është për t'u habitur edhe ky cikël kaq i shpejtuar i njohjes ndërkombëtare i pavarësisë.

Mund të them se është një përgatitje, po ashtu në proces, edhe i shumë vendeve të tjera krahas këtyre që e kanë njohur Kosovën deri më tani. Pra, e kanë konfirmuar se do të njihet Kosova. Dhe kjo shifër kalon mbi tetëdhjetë dhe besoj se do të shtohet ritmi i vendeve që do të përfundojnë me procesin e njohjes. Njëkohësisht mund të them se është gatishmëria e shumicës prej tyre që të vendosin marrëdhënie diplomatike me Kosovën.

Në këtë kuadër mendoj se edhe Selia e Shenjtë ka proceset e veta apo procedurat që do t'i respektojë. Unë me këtë rast dëshiroj të falënderoj edhe një herë sikur që e kam falënderuar në vazhdimësi kontributin e jashtëzakonshëm që ka pasur Selia e Shenjtë në mbështetje të gjithë proceseve në Kosovë. Në radhë të proceseve për lirinë dhe të drejtat njerëzore dhe, natyrisht, për paqen, stabilitetin, e në këtë kuadër natyrisht se i është dhënë mbështetje e drejtpërdrejtë edhe popullit të Kosovës për të kapërcyer atë periudhë të trysisë shumë të vështirë që e ka pasur. Këtë po e ndërlidh me rolin e ve-

çantë që ka pasur Papa Gjon Pali II, Ati i shenjtë, por në të njëjtën kohë edhe një vazhdim jashtëzakonisht i suksesshëm nga Atit i shenjtë, Papa Bendikti XVI.

Çfarë rëndësie kishte për Kosovën dhe pavarësinë e saj vizita juaj në Vatikan?

F. Sejdiu: Po pikërisht e lidhi këtu me këtë që potencova më herët, sepse është një vizitë që bie në kontekstin e një bashkëpunimi shumë të thellë të përfaqësuesve të Kosovës me Selinë e Shenjtë, të një ndjenje të falënderimit të thellë për kontributet e jashtëzakonshme që ka pasur dhe ka Selia e Shenjtë për popullin e Kosovës, për institucionet. Ju natyrisht e keni parë se edhe nga deklaratat e para të Atit të shenjtë, Papa Bendiktit XVI, është konstatimi që vjen edhe nga zyrtarët e Vatikanit se Kosova ka shpallë pavarësinë e vet, dhe sigurisht se do të ndjekim

“ Vizitë në Vatikan ishte në kontekstin e një bashkëpunimi shumë të thellë të përfaqësuesve të Kosovës me Selinë e Shenjtë, të një ndjenje të falënderimit të thellë për kontributet e jashtëzakonshme që ka pasur dhe ka Selia e Shenjtë për popullin e Kosovës, për institucionet. Në këtë kuadër mund të them se ka qenë një vizitë historike, duke pasur parasysh rolin e veçantë që ka Selia e Shenjtë në botën bashkë-

dhe lutjen e tyre të përhershme për paqen dhe stabilitetin. Dhe në këtë kuadër unë kam shprehur konsideratat më të larta të popullit të Kosovës, të institucioneve të Kosovës dhe gatishmërinë tonë që të vazhdojmë me këtë qasje që kemi edhe për liritë shpirtërore apo të komuniteteve, për atë tolerancë dhe koekzistencë të thellë që kanë qytetarët e Kosovës, në radhë të parë shqiptarët. Flas si bashkësi apo si etnitet më vete e që ka tri konfesionet, por që toleranca festare është e dalluar në kuptimin më të mirë të mundshëm; se do të kemi po ashtu konsideratat të larta për liritë shpirtërore të të gjithë të tjerëve. Dhe në këtë kuadër mund të them se ka qenë një vizitë historike, duke pasur parasysh rolin e veçantë që ka Selia e Shenjtë në botën bashkëkohëse. Pas takimit që kam pasur me Atin e shenjtë, kam pasur edhe një takim me sekretarin e shtetit, zotin Bertone, që ishte takim jashtëzakonisht i mirë dhe përmbytësor.

A pritet që Vatikanin të hapë nunciaturën e vet këtu në Kosovë dhe a do të nënshkruhet konkordati mes Republikës së Kosovës dhe Vatikanit?

F. Sejdiu: Unë kam dhënë këtë ide dhe sigurisht se është pranuar me të mirë, që mes shteteve sovranë të ketë, në këtë kuadër, edhe raportet specifike edhe me Selinë e shenjtë, të ketë nënshkrimin e një marrëveshjeje të njohur, domethënë si konkordat, që lidhet me

raportet reciproke, edhe natyrisht me mundësitë e bashkëpunimit sa më të thellë, duke pasur para sysh po ashtu se Selia e shenjtë mund të ketë edhe përfaqësinë e vet, nunciaturën/nuncin e vet. Kjo nënkupton edhe mbështetjen e besimtarëve, por në të njëjtën kohë edhe të mbështetjes së proceseve apo të raporteve diplomatike në kuadër të specifikave që ekzistojnë. Dhe mendoj se kjo duhet të ndodhë në momentet e para, të themi të përgatitura më vonë pas njohjes së pavarësisë së Kosovës edhe nga ana e Selisë së shenjtë, që presim me padurim të ndodhë, sepse ka peshën e vet të veçantë.

Kosova e pavarur është shtet laik. Çfarë statusi do të kenë bashkësitë fetare këtu, cili do të jetë roli i tyre, e në veçanti atyre bashkësitë të vogla, dhe çka pret shteti ynë nga bashkësitë fetare?

F. Sejdiu: Natyrisht se keni të drejtë, Kosova është shtet laik, është një shtet sekular, një shtet që natyrisht e ndan çështjen e besimit nga punët e shtetit. Do të them në një aspekt të një ndarje klasike që ekziston, por në të njëjtën kohë mund të them se me aktet më të larta juridike të vendit, me Kushtetutën e Kosovës, me ligjet e Kosovës që do të jenë specifike, do të garantohen në mënyrën më të mirë të mundshme të gjitha liritë fetare, mundësia e shprehjes së tyre, e organizimit të të gjitha proceseve të nevojshme, të themi ritualeve dhe shumëçka tjetër që lidhet me shprehjen dhe ndjenjen shpirtërore. Në këtë kuadër natyrisht se do të ketë një konsideratë të veçantë ndaj

Pater Ndue Kajtazi me Kryetarin Sejdiu gjatë intervistës



gjithë konfesioneve. Unë s'do ta lidhja në aspektin numerik se ka një konfesion numër më pak të besimtarëve apo një tjetër ka më shumë, por mund të them lirishit dhe me bindje të plotë se trajtimi i shtetit në relacion me to do të jetë i njëjtë. Shteti do të ketë kujdes, pra Kosova e pavarur dhe sovranë, do të ketë kujdesin që secili individ dhe secili komunitet, të themi edhe në kuptimin konfessional, por edhe asaj që mund të themi shprehje e drejtpërdrejtë e ndjenjave shpirtërore, të ketë garanci më të drejtpërdrejta dhe të pacenueshme. Prandaj në Kosovë ju e dini se ekzistojnë, nëse doni pak edhe nga ai aspekti i prezencës jo vetëm figurative, konfesionit islam, konfesionit katolik dhe konfesionit ortodoks, por është shumë me rëndësi, se ne do ta trajtojmë qenien e tyre, sensin e tyre, vepërimitarinë e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme siç trajtohet në botën bashkëkohëse, duke lënë hapësirën e gjithmonshme që të ketë shprehjen e vet kjo liri apo kjo e drejtë njerëzore edhe shpirtërore, të them për të gjithë besimtarët; që të reflektojë në mënyrën më të mirë të mundshme, për të pasur po ashtu, në të njëjtën kohë, edhe pjesën e obligimeve; që të jetë gjithmonë në frymën e tolerancës. Dhe besoj se ashtu ka qenë e ashtu do të jetë.

Republika e Kosovës duhet të jetë shtet laik, a ka rrezik, që ka shumë popuj, shumë struktura të jashtme, në veçanti armiq të Kosovës që kanë qenë kundër pavarësisë që vazhdimisht trumbetojnë se Kosova mund të bëhet një shtet islam?

F. Sejdiu: Jo, Republika e Kosovës do të jetë ashtu siç e potenconi ju dhe që e thamë edhe më herët shtet laik, shtet i shtetaseve të saj, i qytetarëve të saj dhe shtet, në të cilin do të respektohen konfesionet e shumta që ekzistojnë. Do të jetë shtet në të cilin të drejtat dhe liritë e qytetarëve do të jenë në radhë të parë dhe liritë shpirtërore bashkë me to. Por s'do të jetë shtet i dominancës në kuptimin e themi mbizotërimit të një religjioni ndaj religjioneve të tjera dhe qytetarët e Kosovës të jenë pre e ndonjë qasje të tillë. E di dhe e besoj se kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës kanë trumbetuar kohë të gjatë për të bërë apo prezantuar një imazh tjetër për Kosovën para botës, për të prezantuar Kosovën si një shtet islamik, për të prezantuar Kosovën si një trampolinë të orientuar për të destabilizuar Evropën apo për të trumbetuar Kosovën po ashtu si një zonë apo një vend ku s'do të ketë stabilitet dhe raporte të mira ndërqytetare. Është e kundërta. Kosova me identitetin e saj, si dhe bota shqiptare, i kanë takuar dhe i takojnë Evropës. Janë promotorë apo promovues të vlerave më të mira civilizuese, flas edhe në kuptimin shpirtëror apo të besimeve. Mos të harrojmë se pikërisht shqiptarët apo paraardhësit tanë, ilirët, kanë qenë promotorët e parë të krishterimit në Evropë, flas në Ilirik dhe në

“Kosova me identitetin e saj, si dhe bota shqiptare, i kanë takuar dhe i takojnë Evropës. Janë në shtratin e saj të hershëm. Janë promotorë apo promovues të vlerave më të mira civilizuese, flas edhe në kuptimin shpirtëror apo të besimeve. Mos të harrojmë se pikërisht shqiptarët apo paraardhësit tanë, ilirët, kanë qenë promotorët e parë të krishterimit në Evropë, flas në Ilirik dhe në gjithë perandorinë romake. Kemi edhe shenjtoret të rëndësishme si shën Florin e shën Laurin, për të cilët besoj se ju dini edhe më tepër, dhe mos të harrojmë se pikërisht kjo frymë dhe ky gjen i ndjenjës shpirtërore ka reflektuar tek brezat e më vonshëm.”

”

gjithë perandorinë romake. Kemi edhe shenjtoret e rëndësishme si shën Florin e shën Laurin, për të cilët besoj se ju dini edhe më tepër, dhe mos të harrojmë se pikërisht kjo frymë dhe ky gjen i ndjenjës shpirtërore ka reflektuar tek brezat e më vonshëm. Dhe është shumë me rëndësi se kjo qasje që ne kemi pasur, ka hy në sensin e vet të vërtetë në ndërtimin e një shpirti të veçantë të tolerancës dhe të respektit reciprok të njerëzve të një gjaku, dhe mendoj se në asnjë mënyrë, bazë, dhe në asnjë frymë s'mund të marrë dikush shkas dhe alibi për të thënë se shqiptarët, flas tash si shumicë në Kosovë, mund të jenë diçka tjetër. Ata janë edhe islamë, ata janë edhe katolikë, njësoj. Edhe njëri dhe tjetri flasin një gjuhë, janë të një gjaku, kanë një projekt politik. Dhe projekti ynë i përbashkët është ndërtimi dhe zhvillimi në qëndrueshmëri i shtetit të Kosovës së pavarur, i demokracisë në Kosovë, i tolerancës njerëzore dhe respektimi dhe i etniteteve të tjera. Andaj edhe ne do të jemi ata që jemi garant, në radhë të parë të vetvetes në këtë

ecje të suksesshme, por jemi edhe garant edhe të marrim përgjegjësi të stabilitetit dhe rajonal për aq sa i takon Kosovës, duke pasur parasysh edhe ndjenjën tonë të miqësisë apo të fqinjësisë me vendet që i kemi përreth. Është shumë mirë që kemi raporte të shkëlqyeshme, ta zëmë me Maqedoninë, me Shqipërinë, me Malin e Zi. Dhe janë edhe figurat e ecjes së më hershme të personaliteteve të rëndësishme që kanë dhënë, jo vetëm shkrimin e tyre, por edhe shumë nga vepra e tyre jetësore për të instaluar këtë frymë të bashkëpunimit mes popujve. Unë do të marr një shembull të veçantë, shembullin e Nënë Terezës. Një zonjë e bekuar, një nënë e botës, prindërit e së cilës janë të dytë me origjinë nga Kosova, e lindur në Shkup, kapërcim e një pjesë e familjes edhe në Shqipëri. Pra është një simbiozë apo një triangel i udhëtimit të saj, në radhë të parë, në një shtrirje të etnisë, por edhe të bashkëpunimit me të tjerët, dhe një nënë e bekuar që pastaj merr rrugët e botës për të ndihmuar krejt njerëzit, dhe asnjë herë nuk ka hequr dorë për të

thënë se me origjinë jam shqiptarë. Por natyrisht se i takon edhe civilizimit botëror. Kjo frymë dhe kjo ndjenjë, ky sens, besoj se gjakton tek njerëzit tanë, dhe është shumë me rëndësi se krenohen të gjithë që patëm një figurë kaq të rëndësishme, sikurse edhe figurat e tjera të rëndësishme të historisë sonë nacionale të përbashkët.

Kur Selia e shenjtë ta pranojë Kosovën si shtet të pavarur, a do t'i bëni një ftesë Papës ta vizitojë Kosovën?

F. Sejdiu: Unë do ta shfrytëzoj rastin e parë që t'i adresohem Atit të shenjtë, në radhë të parë me falënderimin e sërishëm për mbështetjen që i ka dhënë dhe do t'i japë Kosovës edhe në këto procese që ne supozojmë që do të ndodhin shpejt. Natyrisht, presim me padurim që të jetë nga vizitorët e parë dhe të rëndësishëm që do ta vizitojë Kosovën, që do t'i shohë Prishtinën, Prizrenin, qytetet e bukura të Kosovës. Që do t'i shohë themet e katedrës së re të nisur në Prishtinë, t'i shohë njerëzit e Kosovës që do ti dalin në pritje dhe në lutje të përbashkët. Edhe ata që mund të quhen në kuptimin konfessional islam, edhe ata që janë të përcaktimit katolik, por janë të gjithë shqiptarë.

Dhe në fund, dëshiroj të ju adresoj të gjithëve dëshirat më të mira për Pashkët, për gëzimet që duhet t'i kemi në familje, dhe në refleksionin e përgjithshëm për të kujtuar këtë moment të rëndësishëm të ndjenjës sonë në këtë festë që është e traditës, që do të vazhdojë edhe në breza e në breza dhe ta festojmë bashkë.

Intervistoi:
Pater Ndue Kajtazi, O.F.M.

Vepër me përsiatje të thellë

(Don Nosh Gjollaj, Kush është Frojdi i vërtetë, botoi Faik Konica – Shpresa Prishtine 2008, f. 325.)

Për Frojdin është folur shumë në të kaluarën dhe ende flitet në rrethet e ndryshme shkencore dhe intelektuale. Por shtrohet pyetja e thjeshtë: kush janë ata pak psikologë shqiptarë që patën kurajën dhe guximin t'i qaseshin në mënyrë rrënjësore studimit të jetës dhe veprës së kësaj figure madhore, njëherësh babait dhe themeluesit të psikanalizës botërore. Përgjigja është e thjeshtë, asnjëri nga ata. Po ia doli njëri nga ata që e theu këtë akull dhe tabu frike, i cili me punën e tij disa dekadëshe në lëmin e psikanalizës dhe të botimit të disa librave të mëparshëm nga lëmi i psikologjisë dhe psikanalizës, dëshmoi përkushtimin dhe thellimin në një punë të vyeshme shkencore. Ky është don Nosh Gjollaj, për të cilin, nëse shprehemi me gjuhën e një kolegut të tij L. Oroshit, lirisht mund ta quajmë dhe emërtojmë Frojdi shqiptar.

■ SHKRUAN:
Wilson CULAJ

Të merresh me Frojdin dhe pikëpamjet e tij, do të thotë të ballafaqohesh me disa nga çështjet më të ndërlikshme të mendjes njerëzore, sidomos të vetëdijes dhe nëndijes – pavetëdijes njerëzore. Këta përbërës të mendjes njerëzore edhe sot vazhdojnë të zgjojnë interesimin e studiuesve. Njëri ndër këta studiues është edhe Don Nosh Gjollaj, i cili ditëve të fundit na dhuroi një studim të rëndësishëm dhe krejt të veçantë, përmes të cilit për herë të parë në botën tonë shqiptare ndriçohet një shkallë thelbësore nga lëmi i psikologjisë dhe psikanalizës.

Kjo vepër do t'i shërbejë njeriut tonë për ta njohur vetveten dhe tjetrin përreth nesh duke u nisur nga maksima: "Njohja e vetvetes është fillimi i diturisë-urtisë". Një pjesë e madhe e kësaj veprë i kushtohet shkaqeve të mohimit të Zotit- religjiozitetit nga ana e Frojdit, ku e tërë kjo lidhet me marrëdhëniet e tij në familje, edukimin e tij të hershëm, raportin me nënën dhe babanë, krizat ekonomike familjare, pasoja, të cilat do të shprehen më vonë dhe ndikuan në përcaktimin e tij teorik.

Freudi dhe religjioni

Si përfaqësues i psikanalizës, Frojdi ishte i pari që religjionin

e paraqiti si "Neurozë kolektive", përkatësisht si "Dukuri patalogjike", duke e paraqitur atë si iluzion dhe mashtrim të individëve të dobët në zhvillimin psikik. Siç shprehet don Noshi, Frojdi qysh në fëmijërinë e hershme u ballafaqua me shumë të papritura të rënda. Humbi shërbëtoren Resi, përjetoi krizën ekonomike, ndjeu mungesën e përkrahjes së babës, mosn-grohtësinë e dashurisë së nënës, vdekjen e të afërmeve të familjes, që kushtëzuan në thyerjen e tij shpirtërore. Këtë situatë Frojdi e përmbledh me mendimin se "Natyra është hakmarrëse kurse Zotit i drejtë nuk kujdeset për krijesat e veta". Një faktor tjetër, siç thotë edhe don Noshi, është edhe humbja e gjuhës çeke. "Nëse e humb gjuhën, njeriu humb edhe kujtimet dhe afektet që ndërliiden në raport me të tjerët". Me humbjen e kujdestares Resi humbet edhe kujtesa e vetëdijshme e Frojdit për të. Ai me këtë rast e humbi edhe kishën e Hyjit ku e dërgonte ajo vazhdimisht, dhe mbeti i pasigurt në duart e nënës, të cilën gjatë studimeve të tij e ndërliði me "përfytyrimin ndërpikik të vdekjes". I braktisur dhe i lënduar, vendos të mbështetet te babai, edhe pse çdoherë dëshironte të shkëputej nga ai.


Me gjithë ateizmin e tij, ai nuk mundi të shkëputet tërësisht nga përfytyrimi i Zotit, si në letrat e tij "O Zot i dashur".

Siç thekson studiuesi Gjollaj, refuzimi i Zotit nga ana e Frojdit erdhi si rezultat i dhimbjes që ia shkaktuan prin dërit e tij. Frojdi këtë dhimbje nuk e shfaqti kurrë, por mbështetjen e tij e gjeti tek shkëputja nga besimet infantile. Për Frojdin Zoti nuk ishte asgjë tjetër veçse zëvendësim i mungesës së dashurisë së prindërve. Teza e tij bazë të çon në stoicizëm dhe ateizëm, që sipas Ana Maria Rizzuto, nuk është asgjë tjetër përveçse reflektime të tij nga moshja e re, të përjetuara në gjirin familjar. Është interesante teza e Frojdit se nuk ka dallim të madh në mes të religjionit dhe psikologjisë, se njerëzit religjiozë mund të bëhen adhurues të psikanalizës. Sipas A. M. Rizzuto për përfytyrimin e Zotit nga ana e fëmijës, rol kryesor ka nëna. Në të kundërtën, nëse ka thyerje emocionale, dështim, ankth, pasiguri, braktisje, kjo ndikon në humbjen e besimit në vete të fëmijës dhe përfytyrimin ndërpikik të Hyjit. Në këtë rast te Frojdi hasim qëndrim të vrazhdë ndaj nënës së tij, ku në të vërtetë ai kishte dy nëna, një-rën biologjike dhe kujdestaren Resi. Frojdi e përshkruan atë si edukatoren e tij të parë seksuale, e cila e lante në vaskën me ujë të kuq, e do, e ledhaton dhe e ngacmon e ajo që bërë pasioni i parë seksual, në të cilën edhe dashurohet emocionalisht. Këto raporte me Resin lanë gjurmë të thella në psikikën e njomëzakut

Frojdi. Kështu, në rrafshin e vetëdijes lidhet me Resin, kurse në atë nënvetëdijes me nënën e tij, e cila ishte narcisoide. Ky raport e shoqëron edhe me të dashurën e tij Gizelen, nga e cila frikësohet se do ta braktisë. Kjo ndodh edhe me gruan e tij, Martën. Një faktor që ndikoi në traumat e Frojdit, ishte edhe lidhja e tepëruar narcisoide me nënën e tij. Ky synim për t'u liru nga varësia e tepëruar e nënës, ndikoi në krijimin e konceptit Frojdian që ta shpallë Hyjin dhe religjiozitetin si të vdekur. Nga studimi del se Frojdi që i lidhur me tri figura femërore që ndikuan në jetën e tij, ishte nëna e tij Amalia, kujdestarja Risi dhe gruaja e gjysmë vëllait Edmund, dhe tre persona mashkullorë, si babai Jakob dhe gjysmë vëllazërit Emanueli dhe Filipi. Kështu, hyrja në fazën edipiane Frojdit e gjen me një goditje të thellë shpirtërore. Falë talentit që kishte ai, veten e gjen në identifikimin e tij me heronjtë biblikë, si Jozefin e Egjiptit, Moisiun, Hanibalin, Gjeneralët e Napolonit etj. Si Jakobin po ashtu edhe Amalia, te djali i ri shihnin Moisiun e ri dhe Mesinë e ri të shkencës. Ky rivlerësim i babës së tij për djalin, nuk ishte asgjë tjetër vetëm se shkëputje nga ideali i tij i mëparshëm. Kjo ndikoi që Frojdi ta merrte rolin edhe të babait në familje, mision i cili në të ardhmen do të shndërrohej në mallkim për të. Pika e tij mbështetëse do të bë-

hej shkencën, e cila sipas Leopold Brauer nuk mund ta zëvendësojë besimin në Zot. Pikërisht këtu është pika ndarëse e Frojdit, i cili më vonë do të zhytej në ujërat e ateizmit. Mu për këtë Zoti për Frojdin nuk ishte asgjë tjetër, vetëm një "Fantazmë e pafuqishme". Kjo e shtyri që më vonë të mbështetet në "medicinën ateiste të shkencës". Sipas këtij studimi, del se gjithë atë që bëri Frojdi, nuk ishte asgjë tjetër veçse brendia e tij e krijuar e përfytyrimit ndërpikik të Zotit e që janë incizime dhe përfytyrime të babait Jakob, i cili që herët ra në depresion dhe e humbi ekonominë familjare dhe mbështetjen e tij ndaj fëmijëve. Fatin e tij të jetës, Frojdi e mbështeti në stoicizëm dhe shkencë, ku nuk kish-te vend për shpresë. Frojdi zbuloi themelet e neurologjisë, rrafshin e organit kryesor të veprimtarisë njerëzore, por në anën tjetër kurrë nuk arriti ta zhvillojë anën sakrale, sepse në mënyrë biologjike ja mbylli rrugën vetes para se të nisej në atë rrugë. E tërë kjo e çoi Frojdin kah ajo që të merrej me besëtytni. Këto ndodhi zhvillohen në gjirin e familjes ku fëmija në parzmën e nënës e krijon hapësirën psikike "nëna është pasqyra e fëmijës". I ndikuar nga Feurbach, Darwin, e H. Heine, Frojdi gjer në vdekje u shndërrua në tallës të Zotit, edhe pse u mundua ta tërheq një paralele në mes të obsesionit dhe religjionit. Frojdi nuk mundi t'i

shkencore



tejkalojë prirjet e tij besëtyte, siç lidheshin me numrat 17 dhe 51 që në një mënyrë simbolizojnë frikën e tij nga vdekja.

Religjioni dhe qytetërimi

Në pjesën *"Religjioni dhe Qytetërimi"* Frojdi u mundua ta paraqesë religjionin si nevojë e qytetërimit, i cili e ngrit dhe e largon njeriun nga stadi i kafshës dhe egërsirës dhe se vështirësia me e madhe e qytetërimit është lirimi nga impulsi dhe instinkti. Në studimin e don Noshit vështrohet edhe çështja e përpjekjes se Frojdit që t'i mbulojë ndjenjat e fajit dhe ato ambivalente ndaj iluzionit, gjoja se ai ishte i zgjedhuri i Zotit, shpëtimtari, Mesia i ri. Një pjesë e këtij studimi i kushtohet edhe pikëpamjeve të Frojdit për narcizmin, ku veçohen si entuziazmi i mashtrimeve, narcizmi i prindërve, çrregullimet e narcizmit si *narcizmi im* dhe *i yti* dhe nevojat e narcizmit, që mund të jetë dy llojesh, i shëndoshë dhe patologjik. P.sh. psikoza është një gjendje narcizmi absolut, me të cilën personi ka shkëputur çdo lidhje me realitetin e jashtëm. Këtu dallohen dy lloje të narcizmit primar, narcizmi i imagjinuar apo i nervozës dhe ai faktik apo i skizofrenisë.

Në pjesën *"Babai dhe simbolika e figurave antike"* përshkruhet dëshira e Frojdit për t'u shkëputur nga tradita fetare dhe ritualet, akuzat ndaj vëllait Eli dhe raportit i ftohët me babën. Duke mohuar

religjioni Frojdi themeloi një disiplinë të re metapsikologjinë apo shkencën që e mohon ekzistencën e Zotit. Frojdi duke e përshkruar babanë e tij si "skllavin e vdekur" nuk arriti ta mposhtë atë skllav, por vetë ra në skllavërinë e teorisë së tij.

Freudi i vërtetë – instiktiv, egocentrik dhe shovinist mashkullor

Në pjesën *"Vdekja e nënës si çlirim ose frikë nga vdekja"* autori e lidh me përfytyrimin ndërpsikik të Frojdit Zoti-nëna-fati-vdekja. Këtu përshkruhet nëna e tij Amalia, e cila ishte narcisoide e madhe, ambicioze dhe e pamëshirshme ndaj tij. Është interesant se kjo fazë e jetës së Frojdit apo faza edipiane, kur fëmija dashurohet në gjininë e kundërt të prindërve, mbetet ende enigmë për studiuesit. Këtu na paraqitet edhe Frojdi rebel e jo revolucionar, parim të cilin e kishte bartur nga nëna, e cila kishte dëshirë t'i sundonte të tjerët. Është çudi se Frojdi kurrë fajin nuk e kërkoi tek babai, por atë ia hodhi Zotit. Ai përshkimin e Zotit e bëri ashtu siç ia diktoi struktura e tij e brendshme psikike. I zhytur në karrierën e

vet dhe si dyshues i madh, nuk meritonte të

“ Refuzimi i Zotit nga ana e Frojdit erdhi si rezultat i dhimbjes që ia shkaktuan prindërit e tij. Frojdi këtë dhimbje nuk e shfaqti kurrë, por mbështetjen e tij e gjeti tek shkëputja nga besimet infantile. Për Frojdin Zoti nuk ishte asgjë tjetër veçse zëvendësim i mungesës së dashurisë së prindërve. Teza e tij bazë të çon në stoicizëm dhe ateizëm, që sipas Ana Maria Rizzuto, nuk është asgjë tjetër përveçse reflektime të tij nga mosha e re, të përjetuara në gjirin familjar. ”

bëhej lider politik. Shpresa dhe hidhërimi i tij ishin shtysa më të fuqishme të personalitetit të tij. Në kapitullin *"kush ishte Frojdi i vërtetë"*, përshkruhet se forca e tij emotive ishte pasioni për vetveten dhe mbështetja e tij e madhe tek arsyeja. Analistët Frojdin e përshkruajnë edhe si *instiktiv ndaj arsyes, të dbënë pas seksualizmit dhe shovinizmit mashkullor*. Për Frojdin vetëm mashkulli është genie e plotë njerëzore. Ai nuk diti t'i dallojë as të dy rolet, atë të

fëmijës dhe të babës - të rriturit. Por për çudi vet Frojdi e humbi vetveten mu aty ku i rrëshqiti toka nën këmbë, në familje. Ai nuk deshi t'u besojë të afërmeve, mbase as ai nuk i besoi vetes as ndjenjave të tij. Frojdi në këtë studim na del edhe si xheloz ndaj të rinjve, motrës Martës dhe familjes. Çështja kryesore frojdiane nuk është ajo se çfarë ndjeu, por çfarë bëri Frojdi me ndjenjat e tij. Këtu është edhe humbja e busullës dhe orientimit të Frojdit.

Sipas Erich Fromit, Frojdi nuk ishte njeri që dashuron, por një egocentrik dhe i fryrë nga ideja e misionit të tij. Tek pjesa *"drama familjare"* përshkruhet e tërë ajo minierë ankthi, pasigurie, dhimbjeje, dështimi dhe ndjenja e fajit e trashëguar nga gjiri familjar. Autori i këtij libri ndriçoi edhe çështje të libidosë apo të energjisë dhe impulseve seksuale. Sipas Frojdit, energjia psikike ose libidoja e nxit Idin kurse Idi përmban dy instinkte: instinktin e jetës - erosin dhe atë të vdekjes - tanatosin. Instinkti i jetës - erosi, i ndihmon individët dhe speciet njerëzore të mbijetojnë, kurse tanatosi nënkupton agresivitetin dhe rrënimin.

Nga e tërë kjo, mund të thuhet se Frojdin gjatë jetës e shoqëruan tronditjet familjare ankthi, pasiguria dhe tragjika, edhe pse vdiq i kapluar nga zhgënjimi i thellë. Megjithatë krenaria dhe dinjteti i tij asnjëherë nuk u prekën nga sëmundja, nga humbja dhe zhgënjimi. E tillë është edhe kjo vepër shkencore e don Nosh Gjollaj, e cila na dhurohet krejt e veçantë në llojin e saj dhe, siç shprehet vetë autori, edhe pse çështja e psikanalizës dhe nënvetëdijes është një "skaf i nënshëm".

Lexusve tanë kjo vepër shkencore do t'u ndihmojë që sado pak ta njohin psikanalizën, Frojdin, por më së shumti do të na ndihmojë të gjithëve neve ta njohim dhe hulumtojmë vetveten dhe brendinë tonë.

Botimet e reja



Një kontribut i ri për teorinë e demokracisë

Cështje tejet delikate dhe të rëndësishme që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë mbarebotërore, shtrihen në librin „Paqja ndër Demokratitë” të autorit Dr. Roland Kley, libër ky i përkthyer nga Zef Ahmeti dhe botuar nga „Albanisches Institut” në St. Gallen të Zvicrës.

Termi „Paqe Demokratike” është një term kryesisht i ri në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Paqja demokratike mundohet t'u përgjigjet pyetjeve të tilla si: a bëjnë luftë demokratitë mes veti; kur do të kemi një botë pa luftë? Duke shtjelluar këtë problematikë, ai në të njëjtën kohë, shtron pyetjen, nëse kjo teori është e saktë apo jo? Ai bën një trajtim tejet interesant dhe të kuptueshëm për secilin.

Është e pakontestueshme, se me përkrahjen e demokracisë dhe shtimin e vendeve demokratike, ndihmohet edhe përforcimi i paqes dhe i sigurisë globale. Në anën tjetër do të ishte iluzion të mendohej se në një të ardhme jo të largët paqja demokratike do të zhvillohej deri në atë masë sa që të ndalen të gjitha konfliktet në botë.

Demokracitë nuk luftojnë mes veti, thotë teoria e paqes demokratike, ato luftojnë me autoritete dhe totalitarizëm.

Teorinë e paqes demokratike autori mundohet ta shpjegojë prej këndvështrimeve të ndryshme.

Aspektin demokratik të shpjegimit të teorisë së paqes demokratike, autori e bazon kryesisht në pikëpamjet e Kantit, sipas të cilit demokratitë janë paqësore, sepse qytetarët e tyre kanë qëndrim pacifist dhe se ata i japin më shumë rëndësi shtimit të mirëqenies së tyre se a aventurave luftarake.

Shpjegimi i radhës ka të bëjë me parimin e ndarjes së pushteteve ose të quajtur ndryshe *checks and balances*. Për Michael Walzer dhe Ernest Gellner format e ndryshme kushtetuese-

shtetërore të ndarjes së pushtetit, ndarja dhe kufizimi i pushtetit, të gjitha këto e bëjnë të vështirë që një demokraci të vihet në lëvizje për luftë. Planet e mëdha, (në mes tyre edhe lufta) në vendet demokratike, nuk mund të jetësohen pa krijimin e një koalicioni të gjerë dhe pa aprovimin e disa organeve.

Shpjegimin kulturor mbi teorinë e paqes demokratike, autori e bazon në kulturën e gjetjes së kompromisit në mënyrë paqësore. Vendet demokratike në brendi kanë obligime ndaj parimit të demokracisë për zgjidhjen e konflikteve.

Tek shpjegimi perceptues, thelbësore do të ishte se a e shohin dhe sa e shohin vendet demokratike njëra-tjetër si demokratike. Nëse perceptohen si demokratike, atëherë apriori ia atribuojnë njëra-tjetër një paqdashje, jo vetëm në konfliktet e brendshme, por edhe në ato të jashtme.

Se a është bërë një përmbledhje e mjaftueshme me këto përshkrime mbi paqen demokratike dhe shkaktarët e saj, mbetet të diskutohet. Ekziston edhe një teori, e cila e shpjegon paqen demokratike nga një këndvështrim tjetër. Teoria e realizmit paqen demokratike e shpjegon si paraqitje e njëhershme, regjionale dhe, në aspektin kohor, e kufizuar. Teoria në fjalë përshkruan kohën mbas viti 1945 (pas LDB), ku për një moment na lindin shumë shtete demokratike. Për këtë arsye vetëm këtu, mbase mund të flitet për një paqe demokratike.

Në fund të librit autori jep një mendim personal të bazuar në studime të hollësishme mbi këtë teori dhe shpjegon të ardhmen e teorisë së Paqes Demokratike nga këndvështrimi i tij. Se a ka të ardhme kjo teori dhe kur do të kemi një botë paqësore e pa konflikte, mësoni duke lexuar këtë libër mjaft interesant.

Jak GJONI



Jezus, Fjala që duhet folur, Fjala Hyjnore, 2008

Vitet e fundit, posaçërisht pas vdekjes së Nënë Terezës dhe lumturimit të saj, përveç biografive, kanë parë dritën e botimit edhe disa vëllime lutjesh e meditimesh, të cilat më konkretisht dhe më qartazi pasqyrojnë jetën e Nënë Terezës e cila pikërisht ka shenja dalluese shenjtërie në lutje dhe uratë, përsiatje dhe meditime të thella. Është vështirë të ketë vdekur ndokush në zë shenjtërie e të mos ketë qenë njeri i lutjes dhe i uratës, i përvujtërisë dhe dashurisë. Nënë Tereza vdiq po me këto karakteristika.

Në këtë vëllim kemi mundësi të njohim për së afërmi përshtirësinë e saj, shpirtin e Misionareve të Dashurisë që tashmë në të gjitha kontinentet e botës u shërbejnë më të varfërve ndër të varfër sipas porosisë bazë të hartuar nga vetë Nënë Tereza. Meditimet e shpërndara në të gjitha ditët e vitit na bëjnë të ditur se çdo ditë duhet ta përshkojmë me lutje e uratë, përsiatje dhe meditime. Këto meditime, disa prej të cilave janë edhe letra të shkruara me përzemërsi të veçantë dhe të dërguara me dashuri në adresën e Vëllezërve të Dashurisë, degës mashkullore të misionit të saj të dashurisë, qesin në pah fenë e gjallë dhe besimin e flaktë e të qëndrueshëm të Nënë Terezës, dhe njëkohësisht janë shkollë e veçantë për të gjithë ne që të mësojmë lutjen, e cila është guzra prej nga mund të forcohemi në jetën e virtyteve.

Porositë meditative që do të hasë lexuesi në këtë vëllim janë shkruar kohë pas kohe dhe me maturi; kanë kaluar përmes zemrës së një „samaritaneje të mirë”, e cila si një grua e gjakut shqiptar ia shtoi botës sonë vetëdijen për madhësinë dhe denjësinë një-rëzore.

(Nga hyrja e librit)




Testamenti shpirtëror i Nënë Terezës, Fjala Hyjnore, 2008


Fati i njeriut është të vdesë, dhe shumë syresh kemi dëshirë që pos varrit të lëmë diçka pas vetes. Në të njëjtën vijë qëndroi edhe Gonxhe Bojaxhiu, shqiptarja zemërmadhe dhe shpirt-hyjnizuar, e cila ia kushtoi jetën shuarjes së etjes së Krishtit të kryqëzuar në më të varfrit ndër të varfër. Falë thirrjes së Hyjit, ajo e themeloi rendin e Misionareve të Dashurisë dhe rende të tjera të lidhura ngushtë me këtë mision të shuarjes së etjes. Gjatë rrugëtimit të saj të gjatë joshi gjithë njerëzimin me shpirtin e vet të çiltër dhe të paepur, duke punuar për zbutjen e varfërisë së skajshme dhe duke rrezatuar dritë në botën mbarë. Por edhe ajo, bija e Evës, duhej ta pësonte fatin e njerëzisë dhe të kthehej te Jezusi, të cilin e donte aq shumë. Para se të largohej, deshi t'u linte motrave të saj dhe gjithë botës amanetin e fundit, Testamentin shpirtëror, me të cilin synonte përjetësimin e thirrjes së Krishtit në botë. Nëpërmjet angazhimit të madh të profesorit të nderuar Anton Nikë Berisha, edhe lexuesi shqiptar e ka fatin të shi-

jojë dhe të përsiatë brendinë e të delirit shpirt të Nënë Terezës dhe të vëzhgojë forcën shtytëse të jetës së saj. Përmes fjalëve që ajo shkroi, kemi kënaqësinë të shohim mbushullinë e dashurisë së Krishtit që vërshonte prej shpirtit të saj dhe të sfidohemi që edhe në jetën tonë të përditshme të nisim të shpallim etjen e Krishtit në të varfër.

Brenda Nënë Terezës ishte një Forcë që e lëvizte, që e bënte të gohej në mëngjes dhe t'i jepte çdo gjë Hyjit. Prof. Berisha, pos përkthimit të Testamentit, hyn edhe në shtjellimin dhe analizën e asaj Forcë dhe mënyrës se si Nënë Tereza ishte e lidhur me të dhe na ndihmon që vetë t'i afrohemi atij Shkaku hyjnor që rrihte në zemrën e Nënë, me shpresë që kjo Forcë të ngjallet edhe në jetën tonë, duke i shkaktuar prangat e vetjakësisë dhe duke na dhënë një qëllim të ri në jetën tonë për të përhapur dashurinë e Hyjit në botën e ligështuar për mungesë dashurie. Prandaj me dëshirë të madhe u japim lexuesve tanë këtë Testament shpirtëror dhe lutemi që ai të jetë dobiprurës në jetën tuaj!

(paraqitja e librit)





Qyteti i vjetër i Dubrovnikut

NDRE Durrësaku

Arqipeshkëv i Republikës së Raguzës (II)

“Ndreu i Durrësit, i Urdhrit të Predikuesve, arqipeshkëv i Raguzës, ngushëllues i të varfërve, duke ua falur mëkatet të gjithë atyre nga rishtarët e fesë që vdiqën të pafuqishëm, i cili priftërinë e vet-të shënuar në titull dhe të marr në kuvendin e eprorëve dhe të Selisë së Shën Pjetrit – e ushtroi mirë e lumturisht dhe la pas vete një përmendore të amshuar, në vitin e Zotit 1391. Vdiq, në të vërtetë në ditën e 13 qershorit të vitit 1393”

■ SHKRUAN:
Prof. Dr. Jahja DRANÇOLLI

Gjatë kohës së pontifikatit të Ndreut, në qytetin e Raguzës, por edhe në Romë e më gjerësisht ra murtaja dhe bëri kërdi. Ajo mori shumë viktima. Njoftimet e kohës dëshmojnë se për çdo ditë viktima të murtajës ishin afro 600-800 njerëz. Qyteti i Raguzës u shkatërrua pothuaj tërësisht nga epidemia. Gjatë gjithë kësaj kohe Ndreu, veç shërbimit priftëror në kishë, shtoi edhe shërbimin mjekësor. Kuvendi Dominikan dhe pallatet e tij u shndërruan në spitale të mirëfillta. Në këto vepra të shkëlqyeshme humanitare, përveç Ndreut, u shquan edhe priftërinjtë arbërorë, si *Pjetër Suinis* i Drishtit (Petrum de Svinis de Driuaosto) dhe *Pjetër Caputapi-Arberi* (Petrum Caputapis de Albania), të cilët jetonin dhe vepronin atëbotë në Raguzë.

Më tej, me veprat më të larta të përshpirtërisë, të cilat ua fal të vetëve ky provincial shumë i vëmendshëm, përpiqej që t'i kënaqte të vetët, kështu që u la pasardhësve një përmendore të përmendur. U themelua nga vëllazëria priftërore e Selisë së Shën Pjetrit në Antioki, e shpallur solemnisht më 11 gusht 1391 dhe e shënuar me emrin e vëllazërisë në fjalë. Një vëllazëri e denjë për krijimin e këtij lloji, është shumë i pasur dhe drejtohet sipas ligjeve dhe normave deri në Hirin Hyjnor dhe u qëndron më së afërmi shembujve më të afërm. Papa Siksti IV dhe Klimenti VIII e patën konfirmuar, por edhe papë të tjerë të Romës e pajisën me privilegje të gjera (“[...] quod Sacerdotum Congregationem sub invocatione Cathedrae S. Petri in Anti-

ochia anno 1391. die XI. Augusti a Sixto IV. Et Clemente VIII. Confirmatam, quam proinde alii Summi Pontifices singularibus decorarunt Privilegiis”).

Kjo vëllazëri, e cila u themelua me iniciativën e Ndreut, kreu misionet të shumta, si për shembull, kujdesi për t'i liruar robërit e krishterë, sidomos vendasit e vet nga turqit; për martesën e vajzave të varfra pa priqë; për grumbullimin e pasurisë me qëllime të ushqimit për të varfrit; për ngritjen e spitaleve për të sëmurët; për ngritjen e bujtinave për të varfër, si dhe për ngritjen e bujtinave në vise pasive për priftërinj. Me këto dhe vepra të tjera të devotshme, vetes dhe vëllazërisë së vet ua ngriti zulmën në të gjitha shtrësas popullore.

Prandaj, anëtarët e kësaj shoqate, duke mbajtur mend këto bamirësi, vendosin një pllakë të re në vitin 1742, për Ndreun, prift provincial, fytyrë jona shembullore, e shkruar me kujdes me një mbishkrim të këllë mbivarror:

“Ndreu i Durrësit, i Urdhrit të Predikuesve, arqipeshkëv i Raguzës, ngushëllues i të varfërve, duke ua falur mëkatet të gjithë atyre nga rishtarët e fesë që vdiqën të pafuqishëm, i cili priftërinë e vet-të shënuar në titull dhe të marr në kuvendin e eprorëve dhe të Selisë së Shën Pjetrit – e ushtroi mirë e lumturisht dhe la pas vete një përmendore të amshuar, në vitin e Zotit 1391. Vdiq,

në të vërtetë në ditën e 13 qershorit të vitit 1393” (“Andreas Dyrrhachensis ex Ord. Praed. Archiep. Ragusinus pauperum solatio, defunctorum expiationi, reigionis incremento, Congregatione Presbyterorum instituta, ac titulo S. Petri in Caathedra insignita, sacerdoti infui bene feliciterque gesti aeternum reliquit monumentum, anno 1391. Obiit vero die 13. Junii anno 1393”).

Me guximin dhe me vepra të shkëlqyera Ndreu u bë dëshmitar për veten dhe siguroi kujtimin e të gjithë të pavdekshëmve. Tre-

mbishkrimin, vetë sipas kujtesës, figurën e tij që është shkruar në mermer”:

“Këtu prehet vëlla Ndreu i Durrësit i Urdhrit të Predikuesve, kur ishte provincial e ndërtoi këtë Kuvend [është fjala për Kuvendin Dominikan të Raguzës-J. D.]. Provinciali Dalmacisë, ndërka më pas arqipeshkëv i Raguzës, i cili vdiq më 13 qershor 1393” (“Hic jacet Andreas de Duracio Ord. Praedicatorum, qui cum esset Prior hujus Conventus, factus est Provincialis Dalmatiae, die-nde Archiepiscopus Ragusinus, qui obiit 13. Junii 1393”).

Për më ndorja e tij e dytë mbivarrorë është vendosur nga vëllazëria, të cilët u kujdesën për të dhe shkruan kështu:

“Vëllat Ndreut nga Durrësi i Urdhrit të Predikuesve, burrë hirplotë, i ngritur, i urtë, zulmëmadh, seminarist i këtij kuvendi dikur, i cili ishte drejtues i Provincës së Dalmacisë, arqipeshkëv i Raguzës dhe një prift shumë i besueshëm, anëtar i kolegjit priftëror, i cili titullin e ka nga Selia e Shën Pjetrit, mbrojtës, aty ku prehet hiri i tij, këtë përmendore ia ngrënë. U largua nga të gjallët bariu, më i miri, më 13 qershor, e shtunë 1393”.

Po me këtë emër, *Ndre Durrësaku* (*Andreas de Duracio*, si e ndeshim në dokumente origjinale), gjysmë shekulli më pas e ndeshim ipeshkvin e Senjit.

Edhe ky kishte lindur në Durrës, por nga kapërcyelli i shekullit XIV. Vdiq, ndërkaq në Senj nga mbarrimi i vitit 1456 apo në fillim të vitit 1457. Që në rini kishte hyrë në radhët e Urdhrit Françeskan. Është nënshkruar me titull profesor të teologjisë, si dhe doktor të Shkrimit të Shenjtë, çështje kjo që na shpie te konstatimi se, Ndreu i kishte mbaruar studimet në Universitetin e Padovës, ku dhe u doktorua. Nga burimet që zotërojmë të zbuluara në arkiva të Padovës, Ndreun së bashku me Gjergj Gaparsin (kanonik në kishën katedrale të Durrësit), më 31 janar 1430 e ndeshim të pranishëm në seancën e mbrojtjes së doktoratit të Gjin Gazullit në Universitetin e Padovës. Në vitin 1439, Ndreu u caktua për provincial dhe inkuizitor (gjykatës) të Dalmacisë. Ndërkaq, më 24 shtator të këtij viti u shugurua për ipeshkëv të Senjit, ku shërbeu deri në vdekje (1456/57).

Më 26. X.1448 papati e emëroi kolektor për Dalmaci dhe Kroaci. Nga kjo kohë, Ndreu ishte shumë i pranishëm në jetën kishare në të dy anët e Adriatikut. Për herë të fundit emrin e Ndreut e ndeshim në *post scriptum-in* e *Mesbarit të Parë të Verbnicës* (1456), domethënë të parin të këtij lloji në Ballkan, ku shkruante: “E mbarova këtë meshtar unë dom Toma, unë vikar i Senjit dhe vikar i zotit Ndre (është fjala për Ndre Durrësakun - J. D.), doktor i Shkrimit të Shenjtë, ipeshkëv i Senjit, më 20 mars të vitit të Zotit 1456”. Në vitin e ardhshëm, më 14 nëntor, u emërua për ipeshkëv të Senjit, Nikolla i Modrushtit, gjë që do të thotë se, Ndreu kishte vdekur nga mbarrimi i vitit 1456 ose nga fillimi i vitit 1457. (fund)

“Po me këtë emër, Ndre Durrësaku (Andreas de Duracio, si e ndeshim në dokumente origjinale), gjysmë shekulli më pas e ndeshim ipeshkvin e Senjit. Edhe ky kishte lindur në Durrës, por nga kapërcyelli i shekullit XIV. Vdiq, ndërkaq në Senj nga mbarrimi i vitit 1456 apo në fillim të vitit 1457. Që në rini kishte hyrë në radhët e Urdhrit Françeskan. Është nënshkruar me titull profesor të teologjisë, si dhe doktor të Shkrimit të Shenjtë, çështje kjo që na shpie te konstatimi se, Ndreu i kishte mbaruar studimet në Universitetin e Padovës, ku dhe u doktorua.”

gojnë se i ka këshilluar në mënyrën e duhur dhe të ndershme trashëgimtarët e vet - ipeshkvij raguzanë, ndërsa në kishë përgatiti më së shumti vepra për përdorimin e tyre të shumanshme. Që nga ajo kohë vetëm në ndonjë rast të rrallë, as nuk merren dhe as nuk përdhosen nga brezat e mëpastajmë të priftërinjve.

Në tempullin me të vërtetë të shenjtë të dominikanëve raguzanë, thotë eruditi raguzan, S. M. Cerva (shek. XVIII) “kam shënuar me një njohje të vjetër dhe të thjeshtë të shkrimit nën

Prenkë Jakova

themelues i Operës Shqiptare

"Njerëz dhe artistë si Prenk Jakova nuk janë të çmuar vetëm për kontributin që kanë dhënë. Praninë dhe mungesën e tyre e ndjen shumë shoqëria që i vlerëson të rrallë e, madje, unikë".

—Spiro Ll. Kalemi

■ SHKRUAN:
Akil Mark KOCI / Londër

Përcaktimi i drejtë i çdo veprë artistike, vlerësimi relativ i tyre, gjykimi kritik dhe trajtimi në shumë aspekte, e veçmas në atë estetik dhe artistik, pa dyshim, paraqet një sfidë të madhe në shumë aspekte me të cilën ballafaqohet edhe autori i librit "Prenkë Jakova", Spiro Ll. Kalemi.

Autori në fjalë, në vitin 2006, ka botuar veprën më të re për personalitetin e shuar të muzikës shqiptare Prenkë Jakova, duke dhënë kështu një kontribut të madh dhe të çmuar jo vetëm për muzikologjinë tonë dhe ashtu të re e pa ndonjë traditë të madhe, por edhe për historinë tonë muzikore si shkencë, duke na njohur me veprimtarinë e krijuesve dhe artistëve tanë e sidomos atë krijuese të kompozitorit të shquar shqiptar dhe themeluesit të gjinisë së operës kombëtare shqiptare me dy veprat operen "Mrika" dhe "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Këto dy vepra artistike paraqesin krijime antologjike, jo vetëm si veprat e para por edhe me veçantinë e tyre në kontekstin muzikor dhe më gjerë, në aspektin estetik, si kontribut i çmuar në këtë lëmi. Këto vepra vijnë të tilla, falë pleksjeve dhe refleksit personal me përmasa jo vetëm kombëtare, por edhe universale, nga muzika si gjuhë dhe art i të menduarit me tingujt e saj. E dihet, arti muzikor koncepton një univers përjetimshëm, e jo vetëm çaste të bukura, por edhe kënaqësi shpirtërore deri në pikat kulminante, për të krijuar një vepër me vlera artistike.

Spiro Ll. Kalemi nuk gjurmoi të gjejë metafora për ta ngritur dhe për të bërë elozhe për një krijues me një përkushtim të madh artistik, me ndjenja të sinqerta, siç ishte kompozitori Jakova, por u përpoq të nxirrte në shesh artin e vërtetë të krijimtarisë së këtij eruditi. Kalemi e kishte të qartë se arti paraqet përsosmërinë, e me të edhe qar-

qendrore të narracionit dhe të ligjërimit artistik.

Në parathënie dhe hyrje autori përqendrohet jo vetëm në muzikën e kultivuar shqiptare, por edhe në një panoramë politiko-shoqërore shqiptare që nga shekulli XX, e cila, siç thotë autori, "karakterizohet për liri e pavarësi". Si studiues i historisë së muzikës ai nuk hedh vësh-

mi dhe shtetin e ri shqiptar, i cili me vështirësi konsolidonte qeverinë vet të re.

Mu pra në atë kohë u lind në Shkodër kompozitori ynë i madh Prenkë Jakova, më 27 qershor 1917, kurse vdes 16 shtator 1969 po ashtu në Shkodër. U regjistrua në shkollën fillore dhe më pas edhe në gjimnazin e françeskanëve "Illyricum", të

i cili pas veti la vepra dinjitoze që e paraqitnin atë si personifikim të muzikës së kultivuar. Atë Martini po hapte shtigje të reja në krijimtarinë e atëhershme edhe ashtu amorfe, si "peshqesh" i rrethanave të krijuara nga një Perandori obskurantiste, siç ishte ajo Osmane, e cila plotë pesë shekuj sundoi dhe na imponoi jo vetëm kulturën por edhe gjëra të tjera. Në atë kohë Dom Mikel Koliqi formoi korin "Scholae cantorum" të kishës, në të cilën kompozitori Jakova nuk gjeti vetëm strehim, por zhvilloi një aktivitet të madh.

Pasi mbaron shkollimin, punësohet si mësues muzike në fshatrat e rrethit të Shkodrës dhe ca vende të tjera. Mirëpo dhe mu në atë kohë merret me kompozimin dhe përpunimin e këngëve popullore. Në vitin 1942 regjistrohet në Konservatoriumin "Santa Cecilia" të Romës dhe për të parën herë mëson në një shkollë profesionale. Për jetën dhe veprimtarinë e këtij koslosi muzikor flet gjerësisht, duke e përmendur edhe inskenimin e veprës së Fishtës "Juda Makabe" të cilën për përcjelljen e kësaj tragjedie, Jakova e kompozoi muzikën. Po ashtu kemi inskenimin e Dasmës Shkodrane nga regjisori dhe shkrimtari Andrea Skanjeti, kurse muzikën e kishte përzgjedhur e përgatitur Prenkë Jakova.

Mirëpo, për autorin e këtij libri "Prenkë Jakova", Spiro Ll. Kalemi, rëndësi të veçantë kishin dy operat kompozitorit "Mrika", e kompozuar në bazë të tekstit

“Krijuesi, në fokusin e narratorit, arrin të shprehë me emocionet e tij të flakta, të gjithë besimin në Hyjin si identifikim i një rrezatimi jo mitik, por real, me vibrimet e tij të brendshme shpirtërore. E këto po i spikaste në kohën kur nuk ka pasur mundësi ta shprehte të gjithë atë ndjesi, atë altruizëm si virtyt krijues e që është edhe binom i pa ndarë i artit krijues, sepse jetoj dhe veproj në kohën e një regjimi, kultivues i antivlerash.”

tësinë e shprehjes muzikore që qëndron mbi artet tjera. Autori në fjalë prezantohet me një semantikë të gjerë, të përsosur, me një analizë të mirëfilltë të bazuar në kode relevante muzikologjike dhe me një shpjegim të qartë, esencialisht të thellë e të qenësishëm; të mbështetur në mendimin estetik dhe nga një shprehje e bukur si art i fjalës dhe pikë

trimin vetëm në historiografinë më të re shqiptare, por përfshin periudhat më të hershme që nga viti 1917, kur në Shqipëri, e veçanërisht në Shkodër, si qendër e dijes dhe kulturës shqiptare, edhe pas pesë viteve të shpalljes së pavarësisë, kishte probleme me kufi, me ushtri të huaja, me kapadaillekun e fiseve të verit dhe të jugut, me situatën ekono-

drejtuar nga Atë Gjergj Fishta, kurse muzikën e studioi te kompozitori ynë parë i shkolluar në Austri, Atë Martin Gjoka, që bëhet "udhëheqësi dhe udhërrëfyesi i Prenkës". Largimi i Atë Martin Gjokës ishte një humbje e madhe jo vetëm për Prenkën e ri, por edhe për qytetin e Shkodrës, sepse humbi një veprimtar të pasionuar, një krijues të madh,

Koral nga opera "Mrika"

P. Jakova

Arie nga opera "Mrika"

P. Jakova

Koral për meshkuj nga opera "GJ. K. Skenderbeu"

P. Jakova

Llazar Siliqit dhe "Gjergj Kas- trioti Skënderbeu" të kompozua- ra sipas libretit të poetit Llazar Siliq. Në këtë shkrim do të për- qendrohemi në muzikën sakrale të tij, e cila ngërthen në veti for- cën hyjnore. Krijuesi, në fokusin e narratorit, arrin të shprehë me emocionet e tij të flakta, të gjithë besimin në Hyjin si identifikim i një rrezatimi jo mitik, por real, me vibrimet e tij të brendshme shpirtërore. E këto po i spikas- te në kohën kur nuk ka pasur mundësi ta shprehte të gjithë atë ndjesi, atë altruizëm si virtyt krijues e që është edhe binom i pa ndarë i artistit krijues, sepse jetoi dhe veprroi në kohën e një regji- mi, kultivues i antivlerash. Ishte kohë kur, nën ombrellën e një drejtimi të realizmit socialist, po ndodhte një kataklizëm jo vetëm për artin shqiptar, por po shfaqej edhe si fatalitet për kulturën tonë në përgjithësi. Pra, fjala është për disa qëndrime të kreut të Parti- së izomorfe që e mbyllin dhe e cungojnë krijimtarinë e Jakovës, duke e ndaluar krijimin e të me- nduarit artistik dhe estetik. Kjo në aspektin e gjithëmbarshtëm i jep ambiguitetin e një situatë të zymtë, sepse presioni ndaj artistit ishte evident, edhe pse ky presio- ni askund në botë nuk ka dhënë rezultate të mira. Ky anakronizëm mund ta ndalojë krijimtarinë, por assesi s'mund të ndalojë "proce- sin krijues e sidomos s'mund ta ndalojë dhe t'ia diktojë artistit frymën krijuese".

Megjithatë, kompozitori Ja- kova kompozoi, sipas shënime- ve në libër, edhe katër vepra me

muzikë sakrale; "Ave Maria" për zë-bariton dhe harmonim, kur- se në CD që i është bashkangji- tur librit, kemi interpretimin e shkëlqyer të këngëtarit Frano Lufit me përcjelljen e orkestrës nën drejtimin e dirigjentit Alek-

sandër Qyteza, "Tantum-Ergo për katër zëra dhe harmonium, "Litanitë e Zojës", për tre zëra dhe harmonim dhe "Kënga e Zojës së Shkodrës".

Kështu duke dëgjuar këngën "Ave Maria", që është në CD në

kuadër të librit, jo një herë, por shumë herë kam krijuar për- shypjen se kompozitori Jakova E ka kompozuar këtë këngë me një "frymë" në stilin e këngëve klasike kushtuar Zojës që për- mban në vete një syzhe klasik të një shprehje komplekse, duke iu përmbajtur gjithnjë indivi- dualitetit të tij krijues dhe duke e ruajtur indin njerëzor si kriter artistik; duke dëshmuar jo vetëm talentin dhe priirjen, aftësinë, por dhe duke lënë gjurmë të pa- shlyera në universin e gjithmbar- shëm të muzikës sonë kombëtare dhe nacionale. Për këngen "Ave Maria", autori i librit thotë mes tjerash: "Jehonë të veçantë pati "Ave Maria". E kompozuar rreth dy vite më parë, kur Jakova nuk kishte përvojë fillestare stude- nteske, "Ave Maria", renditet ndër krijimet e para të tij."

Nënvizimi i motivit të lutjes dhe rritja e shkallëzuar e melodi- së zbulojnë cilësi ende të panjo- hura të Jakovës së ri. E shkruar për zë basi dhe e kënduar nga këngëtarit Gaspër Luli, "Ave Ma- ria" mbetet një nga të paktat kri- jime fetare të Jakovës.

Për këngët tjera nuk do të fla- sim, sepse na mungojnë partitu- rat dhe incizimi i tyre. Po të mos e kishte pësuar tragjedinë per- sonale dhe prezencën e regjimit komunist, shtrohet pyetja vetve- tui; sa vepra të tjera sakrale do të kishte kompozuar kompozitori Prenk Jakova?

Dhe për fund, një si rezyme, po citojmë fjalët përfundimtare në këtë libër që përmban në vete universin estetik, shkencor dhe

muzikologjik të autorit, ku thotë "Njerëz dhe artistë si Prenk Jakova nuk janë të çmuar vetëm për kon- tributin që kanë dhënë. Praninë dhe mungesën e tyre e ndjen shumë sho- qëria që i vlerëson të rrallë e, madje, unikë". Prandaj arti i tij është një pledoaje e fuqishme, një art origi- nal, e, mbi të gjitha, do të thoshim, art kombëtar, jo vetëm si vetëdije kombëtare, por si art i papërsë- ritshëm. Sepse jo vetëm që arriti kulmin e të shprehurit artistik për nga intonacionet përplot moti- ve, por kulme të tilla arriti edhe për nga forma, për nga semiotika muzikore si realizim artistik dhe shpirtëror dhe si pasqyrë dinjitetit njerëzor. Ato krijime janë perla të muzikës popullore, që shprehin thellësinë e shpirtit të muzikës shkodrane. Gjithmonë e ka pasur moton e Kamys "Të jetosh nuk do të thotë të përkulesh". Para ti- ranit kur ia bën pyetjen, pas një vizite në Shkodër, "Ke premtuar Prenk se pas operës Mrika do ta kompozosh edhe operën tjetër për Gjergj Kaqstriotin - Skë- ndërbeu". Prenka iu përgjigj "Po, more shoku Enver, por puna e operës nuk është si bukët që i fut në furrë".

Pra, i dinjitetshëm, guximtar, krijues me përkushtim të madh artistik, i pa përkultur, gjithnjë duke ecur në jetë vertikalisht; krijues me përmasa universale, i devotshëm, emblemë jo vetëm muzikore, por edhe njerëzore dhe e identitetit nacional; si i tillë me të gjitha këto veti, edhe pse vdiq tragjikisht, ai është pje- së e panteonit të pavdekshëm kombëtar.



Prenk Jakova

TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES



Jam mik i Kishës Katolike dhe dua ta ndihmoj ndërtimin e Katedrales "Nëna Terezë" në Prishtinë!
Gjithë juve miq dhe bamirës të dashur ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xhirollogarive bankare.
Faleminderit!

 **Raiffeisen BANK**
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A